



Raporti Vjetor i Corrwatc (Shkurt 2024 - Shkurt 2025)

Projekti "Mbështetje për Shoqërinë Civile për të Rritur Mbikëqyrjen Publike dhe Llogaridhënien e Institucioneve Publike të Kosovës" financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti GAP (GAP) dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), dhe nuk pasqyron domosdoshmerisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.



British Embassy
Pristina



Group for Legal
and Political
Studies



INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Raporti Vjetor i Corrwatc (Shkurt 2024 - Shkurt 2025)

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Përmbledhje jo-teknike | 4 |
| 1. Metodologjia e Monitorimit | 5 |
| 2. Rekrutimi në Institucionet Publike në Kosovë | 7 |
| 3. Prokurimi Publik | 17 |
| 4. Shpërndarja e Granteve dhe Subvencioneve | 23 |
| 5. Lëshimi i Licencave, Lejeve dhe Tarifave | 28 |
| 6. Performanca e Ndërmarrjeve Publike | 31 |

Përmbledhje jo-teknike

Në qershor të vitit 2022, konsorciumi i themeluar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti për Studime të Avancuara GAP dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) lansoi një projekt trevjeçar që ka për synim rritjen e mbikëqyrjes publike dhe llogaridhënies brenda institucioneve publike të Kosovës. Kjo iniciativë, e njohur si CorrWatch, mbështetet nga Zyra e Jashtme, Commonwealth & Development (FCDO) përmes Ambasadës Britanike në Kosovë.

CorrWatch mbulon pesë komponentë: 1. proceset e rekrutimit në sektorin publik, 2. prokurimin publik dhe menaxhimin e kontratave, 3. shpërndarjen e granteve dhe subvencioneve, 4. dhënieve të lejeve, licencave dhe tarifave si dhe 5. performancën dhe menaxhimin e ndërmarrjeve publike. Nga shkurti 2024 deri në shkurt 2025, u krye monitorim sistematik për secilin komponent.

Sikurse edhe në vitet e mëparshme, në proceset rekrutuese, shqetësim kryesor ishte numri i lartë i ushtruesve të detyrës në pozita të larta në shërbimin civil dhe publik. Krahas vazhdimit të kësaj praktike negative të numrit të lartë të ushtruesve të detyrës, gjatë kësaj kohe shumë institucione po ashtu kanë tejkaluar afatet ligjore ekzistuese për mbajtjen e pozitave të lira me ushtrues detyre. Në këtë periudhë CorrWatch ka monitoruar gjithsej 48 procese rekrutimi për pozita drejtuese të nivelit të lartë, duke përfshirë procese të përsëritura për shkak të anulimeve të mëparshme. Në mënyrë të pashmangshme, CorrWatch pati ndikim të madh në përmirësimin e këtyre proceseve, si dhe në anulimin e 8 prej këtyre proceseve për shkak të parregullsive të konstatuara. Ndryshe nga viti i kaluar, numri i konkurseve të hapura është rritur gjatë kësaj periudhe monitorimi, por cilësia e procesit të rekrutimit në një sërë rastesh nuk është përmirësuar ndjeshëm.

Në fushën e prokurimit publik, kjo periudhë monitorimi është karakterizuar me mungesë të theksuar planifikimi dhe e efikasiteti, si dhe në shumë raste, institucionet kanë kryer aktivitete prokurimi që nuk kanë qenë të parashikuara në planet e prokurimit. Si rezultat, prokurimi publik vazhdon të mbetet i dobët dhe i ndjeshëm ndaj korrupsionit të mundshëm dhe praktikave të dëmshme të shpenzimit të parasë publike. Gjatë këtij viti, CorrWatch ka monitoruar gjithsej 19 aktivitete të prokurimit publik dhe ka identifikuar shkëlqje në dy procese të rëndësishme, siç janë blerja e librave shkollorë dhe furnizimi me ushqim për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në komponentën e granteve dhe subvencioneve, CorrWatch nuk ka vërejtur ndonjë përmirësim të madh gjatë kësaj periudhe. Përveç mungesës së transparencës, institucionet e targetuara si Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), vazhdojnë të jenë të ndjeshme ndaj keqpërdorimeve gjatë ndarjes së granteve dhe subvencioneve, duke theksuar qartë nevojën për digjitalizim - një rekomandim i kahershëm i CorrWatch. Në këtë komponent, CorrWatch ka monitoruar dy skema të granteve – një në MKRS dhe një tjetër në MBPZHR. Ndërhyrja e CorrWatch ka çuar në një përmirësim në një fazë

të caktuar të procedurës së skemës së granteve të prezantuar nga MKRS, e cila është e elaboruar në seksionet më poshtë.

Sfida të ngjashme janë vërejtur gjithashtu edhe në proceset e dhënies së lejeve dhe licencave. Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies në procedura është konstatuar në proceset e monitoruara në të dy institucionet e targetuara, përfshirë Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM). Mungesa e transparencës në këto procedura e ndërlikon edhe më shumë gjendjen, duke marrë parasysh edhe procedurat ekzistuese burokratike që i bëjnë këto procese më të ndjeshme ndaj korrupsionit dhe keqpërdorimeve. Për dallim nga kjo, në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE), është vërejtur një nivel më i lartë i transparencës gjatë kësaj periudhe monitorimi. CorrWatch ka monitoruar 70 debatet publike të organizuara nga MMPHI dhe 4 procese të ZRRE-së lidhur me tarifat, të cilat janë të elaboruara më tej në seksionet vijuese të këtij raporti.

Në Ndërmarrjet Publike (NP), transparenca dhe llogaridhënia janë përmirësuar deri diku, megjithatë jo në të gjitha prej tyre. Nevoja për ndryshime themelore dhe sistematike mbetet ende një kërkesë urgjente, pasi standardet aktuale të aplikuara nga NP-të nuk ofrojnë funksionim të duhur. Gjatë kësaj periudhe, CorrWatch ka monitoruar 20 mbledhje të bordeve, si dhe vendimet e bordeve dhe planet përkatëse të tyre.

1. Metodologjia e Monitorimit

Raport Vjetor ndjek kuadrin metodologjik të vendosur nga iniciativa CorrWatch. CorrWatch përdor një metodologji të shumëanshme, duke përfshirë një sërë indikatorësh të vlerësimit të gjithanshëm që zbatohen në të gjitha pesë komponentët e monitoruar, së bashku me metrika të përshtatura me synim arritjen e rezultateve të prekshme brenda secilës fushë. Qasja metodologjike është e strukturuar për të adresuar katër pyetje kyçe: çfarë, pse, si dhe ndikimi përfundimtar. Para fillimit të aktiviteteve të monitorimit në vitin 2022, u krye një vlerësim i thellësishëm i nevojave në mënyrë që të identifikohen fushat e fokusit dhe institucionet potenciale që kërkojnë ndërhyrje. Në përgjithësi, metodologjia e CorrWatch identifikon modele dhe veprime specifike brenda sektorëve të targetuar që pengojnë efikasitetin dhe performancën e institucioneve publike. Nëpërmjet monitorimit sistematik, mbledhen dhe analizohen informacione për secilën fushë për të identifikuar modelet dhe mangësitë, të cilat më pas adresohen përmes rekomandimeve specifike të paraqitura në raportet periodike.

Seksioni vijues ofron një përmbledhje të shkurtër të qasjes metodologjike të aplikuar për secilin komponent.

Në komponentin e parë, i cili ka në qendër monitorimin e **proceseve të rekrutimit** brenda administratës publike, CorrWatch përqendrohet kryesisht në rekrutimet brenda shërbimit civil, NP-ve dhe agjencive të pavarura, me fokus të veçantë në pozitat e larta. Metodologjia e CorrWatch shqyrton

me kujdes të gjitha fazat e një procesi rekrutimi, duke përfshirë kriteret dhe procedurat, përbërjen e komisioneve të pranimit, verifikimin e njohurive (duke përfshirë testimin dhe intervistimin), si dhe efektivitetin e mekanizmave të ankesave. Ky llojë monitorimi kombinon angazhimin proaktiv gjatë fazave të rekrutimit me një hulumtim të thelluar në tavolinë, duke siguruar një ekzaminim të plotë të secilës fazë të procesit. Për më tepër, CorrWatch përdor teknika të analizës së të dhënave për të identifikuar tendenca dhe modele, duke mundësuar ofrimin e rekomandimeve të synuara për përmirësimin e praktikave të rekrutimit.

Në komponentin e **prokurimit publik**, ngjashëm me komponentin e parë, metodologjia parasheh monitorimin e fazave në vijim: planifikimi i buxhetit, planifikimi i prokurimit, përgatitja e specifikimeve teknike hapja dhe vlerësimi i ofertave, procedura e ankimit pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe menaxhimit të kontratës.

Në kuadër të iniciativës, ndërhyhet edhe në fushën e **dhënies së granteve dhe subvencioneve** nga institucione të caktuara publike. Iniciativa përfshin ndërhyrjet që synojnë përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së disa institucioneve publike në Kosovë, veçanërisht në fushën e dispozitave të granteve dhe subvencioneve. Historikisht, ka pasur mungesë të mbikëqyrjes së jashtme mbi proceset thelbësore brenda institucioneve publike të Kosovës, duke përfshirë ndarjen e granteve dhe subvencioneve, e që ngritën shqetësime lidhur me transparencën dhe llogaridhënien.

Metodologjia e monitorimit për **lejet, licencat dhe tarifat** sipas CorrWatch ndahet në dy kategori kryesore. Kjo qasje veçzohet në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjithë procesin, duke filluar me shpalljen, procedurat dhe kriteret si dhe miratimin e tyre. Për të luftuar në mënyrë efektive korrupsionin, CorrWatch përdor strategji të dyfishtë të vëzhgimit të drejtpërdrejtë dhe kërkimit në tavolinë, të përshtatur me misionin dhe objektivat e organizatës. Kjo metodologji bazohet në analiza të gjera të proceseve dhe përvojave të kaluara për të siguruar monitorim dhe vlerësim të plotë.

CorrWatch ka qasje metodologjike të dyfishtë sa i përket **NP-ve**. Së pari, disa NP janë përzgjedhur dhe monitorohen drejtpërdrejt në aspektin e performancës dhe qeverisjes, bazuar në kompleksitetin e tyre ose problemet strukturore që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme. Në këtë drejtim, CorrWatch fokusohet gjithashtu në tre aspekte kryesore: transparencë, llogaridhënie dhe efikasitet. Sa i përket **transparencës** – monitorimi përqendrohet në: disponueshmërinë e raporteve të kënaqësisë së qytetarëve si në faqet e internetit të kompanisë ashtu edhe të njësisë monitoruese, publikimin e rregullt të të dhënave sasiore siç kërkohet me ligj, qasje në pasqyra financiare të konsoliduara dhe të rregulloreve të kompanisë online, si dhe publikimin e raporteve vjetore të performancës.

Sa i përket **Llogaridhënies** – në fokus janë: rregullsia e vlerësimeve të kënaqësisë së klientëve, reagimin ndaj ankesave të konsumatorëve, normat vjetore të ankesave të ndara sipas gjinisë së ankimesit, kanalet e komunikimit dhe nismat e angazhimit me konsumatorët, respektimin e dispozitës për shkarkimin e anëtarëve të bordit që nuk arrijnë të përmbushin objektivat financiare. Sa i përket **Efikasitetit** – monitorimi i CorrWatch përqendrohet te: tendencat e rritjes së konsumatorëve gjatë dekadës së fundit, normat e

arkëtimit në raport me faturimin dhe borxhet e papaguara të konsumatorëve, tendencat e fitimit/humbjes gjatë dekadës së fundit, raporti i shpenzimeve operative ndaj të ardhurave totale, shpenzimet e përfaqësimit si përqindje e shpenzimeve totale, rezultatet e proceseve gjyqësore, përfshirë rastet e humbura dhe parashkrimet e tejkaluara. Së dyti, CorrWatch ndjek nga afër proceset e emërimit të anëtarëve të bordeve. Meqenëse këto borde janë të ngarkuara me menaxhimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve, emërimet transparente dhe të bazuara në meritë janë esenciale. Ndërkohë që metodologjia e monitorimit synon të evidentojë mangësitë, të ofrojë zgjidhje konkrete të politikave me qëllim që të mbështesin NP-të e përzgjedhura në përmirësimin e performancës së tyre financiare dhe operacionale. Kjo arrihet përmes monitorimit aktiv të mbledhjeve të bordeve dhe hulumtimit.

2. Rekrutimi në Institucionet Publike në Kosovë

Gjatë kësaj periudhe monitorimi, procesi i rekrutimit është karakterizuar me ndryshime themelore, duke marrë parasysh hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Zyrarët Publikë.¹ Ky ligj e ka decentralizuar procesin e rekrutimit, por gjithashtu ka sjellë ndryshime procedurale që jo gjithmonë kanë qenë në favor të efikasitetit të rekrutimit, çka do të elaborohet më tej në seksionet në vijim. Ndryshe nga periudha e mëparshme, ky vit monitorimi ka shënuar një rritje të numrit të procedurave të hapura në nivelin e lartë menaxherial. Në vitin 2023, ka pasur vetëm 20 procedura në nivelin e lartë menaxherial, ndërsa në vitin 2024 ky numër është rritur në 74 procedura.² Rritja e numrit nuk do të thotë se ka më shumë pozita të lira, pasi këto pozita kanë qenë të lira edhe në vitin 2023, duke lënë si shpjegim të vetëm për këtë situatë vullnetin politik. Gjatë kësaj periudhe, CorrWatch ka arritur të identifikojë një sërë problemesh, përfshirë përzgjedhje të paligjshme të kandidatëve në listën e ngushtë, gabime në testin me shkrim dhe praktika të dobëta si në fazën e testit me shkrim, ashtu edhe në fazën e intervistës. Gjithashtu, ngjashëm me periudhën e mëparshme, edhe këtë vit e ka karakterizuar një numër i lartë i zyrtarëve ushtrues detyre në pozita të larta menaxheriale, siç janë sekretarët e përgjithshëm të ministrive, apo nivelet e larta menaxheriale në agjencitë ekzekutive.

Gjatë kësaj periudhe monitorimi, CorrWatch ka monitoruar proceset e mëposhtme të rekrutimit:

1. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Sekretar i Përgjithshëm
2. Fondi për Sigurime Shëndetësore – Drejtor
3. Telekom i Kosovës – Drejtor i Bordit

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-097 për Zyrarët Publikë, 18 shtator 2023, i qasshem në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430>

² Të dhënat u mbledhën nga Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) gjatë periudhës janar – shkurt 2025, i qasshem në: <https://konkursi.rks-gov.net/>

4. KEK – Kryeshef Ekzekutiv
5. Autoriteti i Aviacionit Civil – Drejtor i Përgjithshëm (dy herë)
6. Ministria e Mbrojtjes – Sekretar i Përgjithshëm
7. Komisioni i Pavarur i Mediave – Kryeshef Ekzekutiv
8. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë – Drejtor i Përgjithshëm
9. Trepça SH.A – Bordi Mbikëqyrës (dy herë)
10. Agjencia e Pylltarisë së Kosovës – Drejtor Ekzekutiv (dy herë)
11. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale – Anëtar Bordi
12. Inspektorati në Ministrinë e Drejtësisë – Drejtor Ekzekutiv
13. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Sekretar i Përgjithshëm (tre herë)
14. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – Sekretar i Përgjithshëm
15. Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" – Auditor i Brendshëm (tre herë)
16. Administrata Tatimore e Kosovës – Drejtor i Përgjithshëm
17. Agjencia për Shoqërinë e Informacionit – Drejtor i Përgjithshëm
18. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar – Drejtor i Përgjithshëm
19. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë – Drejtor i Përgjithshëm (dy herë)
20. KQZ – Drejtor i Sekretariatit (dy herë)
21. Ibër Lepenc – Kryefinancier (dy herë)
22. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale – Drejtor i Përgjithshëm
23. Instituti i Kosovës për Administratë Publike – Drejtor i Përgjithshëm (dy herë)
24. Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale – Drejtor Ekzekutiv (dy herë)
25. KQZ – Ekspert për kontroll financiar
26. Agjencia e Punësimit të Kosovës – MFPT – Drejtor Ekzekutiv (dy herë)
27. ZKM – Inspektor i Përgjithshëm
28. Agjencia për Regjistrimin Civil – Drejtor Ekzekutiv
29. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas – Drejtor Ekzekutiv
30. Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve – Drejtor Ekzekutiv
31. Agjencia për Mbështetjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve – Drejtor i Përgjithshëm
32. Kuvendi i Republikës së Kosovës – Sekretar i Përgjithshëm
33. Ministria e Ekonomisë – Sekretar i Përgjithshëm
34. Agjencia e Statistikave të Kosovës – Drejtor Ekzekutiv
35. Agjencia Kosovare e Privatizimit – Drejtor Ekzekutiv (dy herë)
36. RTK – Drejtor i Përgjithshëm
37. Agjencia për Regjistrimin Civil – Drejtor Ekzekutiv
38. Agjencia për Barazi Gjinore – Drejtor Ekzekutiv
39. Agjencia për Siguri Kibernetike – Drejtor Ekzekutiv
40. Korporata Energjetike e Kosovës – Bord
41. Ministria e Shëndetësisë – Inspektorati Shëndetësor – Kryeinspektor Shëndetësor (tre herë)

42. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit – Drejtor i Përgjithshëm
43. Thesari i Kosovës – Drejtor Ekzekutiv
44. Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit – Sekretar i Përgjithshëm
45. Agjencia për Pronën Industriale – Drejtor i Përgjithshëm
46. Inspektorati në Ministrinë e Drejtësisë – Drejtor Ekzekutiv
47. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK) – Drejtor i Përgjithshëm
48. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – Sekretar i Përgjithshëm.

2.1. Mbështetja e institucioneve në ushtrues detyre për pozitat e larta drejtuese

Ndryshe nga korniza e mëparshme ligjore, Ligji Nr. 08/L-097 për Zyrtarët Publik (LZP) rregullon dhe njeh funksionimin e një pozite menaxheriale me një zyrtar ushtrues detyre. Neni 35 i Ligjit parasheh që nëse një pozitë mbetet e lirë, mund të emërohet një ushtrues detyre për një periudhë të caktuar kohore.³ LZP cakton një mandat fillestar prej 6 muajsh dhe, nëse e njëjta pozitë nuk mund të plotësohet, ai mund të zgjatet edhe për 6 muaj të tjerë, pra gjithsej 1 vit.⁴ Në momentin kur ligji ka hyrë në fuqi, ka pasur një numër të madh zyrtarësh ushtrues detyre në nivel menaxhimi. Pavarësisht se kanë kaluar afatet ligjore të mandatit 1-vjeçar, shumë nga këto pozita mbeten të pa-plotësuara. Problemet që çuan në këtë situatë cilësohen të jenë: numri i vogël i kandidatëve, mungesa e kandidatëve të kualifikuar, shkeljet procedurale që çuan në anulimin e procedurave, dhe mos-hapja e disa konkurseve. Nga 74 procedurat e nisura në vitin 2024 në nivelin e menaxhimit të lartë, 10 prej tyre dështuan si rezultat i numrit të ulët të kandidatëve.

Në shtator 2024, CorrWatch reagoi publikisht ndaj kësaj situatë, duke i njoftuar institucionet për numrin e lartë të zyrtarëve si ushtrues detyre.⁵ U vu theks i veçantë në faktin se kjo situatë ngreh pas një pasojë tjetër ligjore, e cila është shpallja e paligjshmërisë së çdo vendimi të marrë nga zyrtarët ushtrues detyre pasi të kalojnë afatin 1-vjeçar të paraparë nga ligj⁶. Kjo situatë shkaktoi konfuzion të madh mes zyrtarëve publikë dhe qytetarëve. Për më tepër, institucionet morën pak ose fare hapa për të përmirësuar situatën aktuale. Madje në disa raste, thjesht i zëvendësuan zyrtarët ushtrues detyre që kaluan afatet ligjore me zyrtarë të tjerë publikë, duke minuar kornizën ligjore aktuale. Përveç kësaj, fenomeni i zyrtarëve ushtrues detyre shquhet për mungesë të theksuar transparence dhe llogaridhënieje ndaj publikut, në veçanti në mënyrën se si kjo situatë po trajtohet dhe/ose zgjidhet nga institucionet përkatëse. CorrWatch konsideron se transparencja institucionale në këtë drejtim është e domosdoshme, duke pasur parasysh faktin se vendimet e paligjshme të ndërmarra nga zyrtarët ushtrues detyre që kanë kaluar afatet ligjore kanë një ndikim të drejtpërdrejtë tek qytetarët,

³ Fletorja Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-097 për Zyrtarët Publikë, Neni 35, Paragrafi 1, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430>

⁴ Po aty, Neni 35, Paragrafi 3

⁵ CorrWatch, "REAGIM PUBLIK – Për Mbajtjen në Mënyrë të Paligjshme të Pozitave Drejtuese me Ushtrues Detyre", 27 Shtator 2024, i qasshëm në: <https://corrwatch.org/2024/09/30/reagim-publik-per-mbajtjen-ne-menyre-te-paligjshme-te-pozitave-drejtuese-me-ushtrues-detyrereagim-publik/>

⁶ Fletorja Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-097 për Zyrtarët Publikë, Neni 35, Paragrafi 5, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430>

duke çuar në shkelje të mundshme të të drejtave dhe interesave të individëve, veçanërisht nga institucionet që janë të ngarkuara me ofrimin e shërbimeve publike.

2.2. Paligjshmëri në listat e ngushta

Një tjetër praktikë negative që është përsëritur gjatë kësaj periudhe janë praktikat e paligjshme gjatë fazës së verifikimit paraprak. Ka pasur disa raste ku kandidatët që nuk i përmbushnin kriteret ose nuk kishin të gjitha dokumentet përkatëse të ngarkuara sipas konkursit janë përzgjedhur për në fazën tjetër. Në rastin e konkursit për pozitën e drejtorit të Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC) të hapur në mars 2024, 3 kandidatë që nuk e përmbushnin kriterin e përvojës profesionale (8 vjet përvojë pune profesionale dhe 5 vjet përvojë menaxheriale) u futën në listen e ngushtë. CorrWatch e konsideroi këtë listë të AAC-së si të pavlefshme dhe rekomandoi një rishikim për të siguruar një proces të rregullt, në përputhje me kriteret dhe procedurat ligjore. Megjithatë, rekomandimet e CorrWatch nuk u morën parasysh, çka çoi në një reagim publik⁷ që më vonë rezultoi në nisjen e hetimeve nga Policia, me urdhër të Prokurorisë. Pas vendimit të Këshillit të Pavarur të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK) për ta kthyer procedurën në fazën e verifikimit paraprak⁸, në të cilin rast KPMSHCK konfirmoi edhe gjetjet e CorrWatch, AAC anuloi konkursin dhe vendosi ta hapë përsëri në janar 2025.⁹

Një situatë e ngjashme ka ndodhur edhe me pozitën e Drejtorit të Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit (ISA), një agjenci brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Gjatë monitorimit të fazës së verifikimit paraprak për këtë proces rekrutimi, CorrWatch ka identifikuar disa shkelje të kuadrit ligjor ekzistues. Më konkretisht, MPB ka përzgjedhur kandidatë që nuk i përmbushnin kriteret e përcaktuara në konkurs, veçanërisht ato lidhur me kërkesat ligjore për përvojën e punës dhe provën që nuk kishte masa disiplinore të zbatueshme ndaj kandidatit, e cila është një kërkesë për pozitën e menaxhimit të lartë. CorrWatch ngriti këto shqetësime në lidhje me institucionin dhe komisionin e vlerësimit, dhe gjithashtu bëri një reagim publik¹⁰, duke rekomanduar një rishikim të procesit për shkak të shkeljeve ligjore të përmendura më parë. Megjithatë, ministria vazhdoi me procesin e rekrutimit, duke legjitimuar një proces të paligjshëm për shkak të shkeljeve të ligjit. Pas vendimit të KPMSHCK-së mbi ankesën e një kandidati në këtë proces, procedura u kthye në fazën e verifikimit paraprak dhe më pas u anulua, pasi u përcaktua se asnjë nga kandidatët nuk i përmbushte kriteret e kërkuara.

Në një rast tjetër, CorrWatch vërejti se Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) kishte vepruar në mënyrë të ngjashme, duke përfshirë kandidatë që nuk plotësonin kriteret në listën e ngushtë, për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Akreditimit. Më konkretisht, lista e rezultateve të verifikimit paraprak përfshinte dy kandidatë, megjithëse vetëm një prej tyre

⁷ CorrWatch, REAGIMI PUBLIK – Procesi i rekrutimit për Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil karakterizohet nga shkelje: CorrWatch bën thirrje për rishikim, 15 maj 2024, në dispozicion në: <https://corrwatch.org/2024/05/30/reagim-publik-10/>

⁸ Vendimi i KPMSHK A.nr.981/2024

⁹ Konkursi për Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil, SIMBNJ, i qasshëm në: <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00016462>

¹⁰ CorrWatch, "Procesi i rekrutimit për Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit karakterizohet nga shkelje: CorrWatch bën thirrje për rishikim", 12 korrik 2024, i qasshëm në: <https://corrwatch.org/2024/07/12/reagim-publik-11/>

i plotësonte kushtet e përgjithshme ligjore dhe kriteret përvojës së punës të përcaktuara në konkurs. Gjithashtu, në listën përfundimtare të rezultateve, të dy kandidatët u shpallën fitues dhe avancuan në fazën përfundimtare të emërimit.

Përveç shërbimit civil, parregullsi të ngjashme janë vërejtur edhe në ndërmarrjet publike (NP), më saktësisht gjatë rekrutimit për anëtarët e bordit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Gjatë fazës së verifikimit paraprak, CorrWatch ka evidentuar se pesë (5) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë nga Komisioni Rekomandues dhe janë ftuar për intervistë, megjithëse nuk i kanë plotësuar kriteret ligjore të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike.¹¹ Më saktësisht, katër kandidatë nuk kishin përvojën e kërkuar në menaxhmentin e lartë, ndërsa një kandidat (i cili u tërhoq nga procesi pas verifikimit paraprak) nuk kishte dorëzuar një letërnjoftim valid, siç kërkohet. Konkursi i shpallur nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit (ZKM) përcakton qartë se “Aplikacionet jo të plota nuk do të shqyrtohen”. CorrWatch ka rekomanduar ZKM-në dhe Komisionin Rekomandues që të rishikojnë listën e ngushtë në përputhje me kriteret dhe procedurat ligjore në fuqi. Megjithatë, Komisioni nuk e mori parasysh rekomandimin e CorrWatch dhe vazhdoi me intervistimin e kandidatëve¹², duke i rekomanduar Qeverisë 13 kandidatë, 3 prej të cilëve ishin përfshirë në listë edhe pse nuk i plotësonin kriteret.

2.3. Tejkalimi i Afateve – Pamundësi Institucionale për t’i Zbatuar apo Vonesë e Qëllimshme?

Sipas Rregullores (GRK) Nr. 05/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores (GRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, pas verifikimit paraprak, testi me shkrim duhet të mbahet brenda 15 ditëve nga publikimi i listës së ngushtë.¹³ E njëjta rregullore zbatohet edhe për intervistën, e cila përcakton se procesi i intervistimit duhet të mbahet brenda 15 ditëve pas publikimit të rezultateve të testit me shkrim.¹⁴ Këto afate janë caktuar për t’i mbajtur institucionet përgjegjëse për efikasitetin e procedurës dhe për të shmangur vonesat e paarsyeshme. Megjithatë, këto afate ligjore mund të paraqesin edhe rrezik real për t’u përdorur si mekanizma për të çuar në anulimin e konkurseve kur ato nuk respektohen, prandaj institucionet përgjegjëse duhet t’i rishikojnë këto afate për të shmangur zbrazëtira të tilla që mund të çojnë në parregullsi dhe paligjshmëri.

Gjatë kësaj periudhe monitorimi, CorrWatch vuri në dukje se afatet ligjore janë injoruar në disa raste, si nga institucionet që udhëheqin procesin e rekrutimit ashtu edhe nga KPMSHCK. Për shembull, në rastin e Ministrisë së Mbrojtjes është tejkaluar afati 15-ditor nga publikimi i rezultateve të testit me shkrim deri në intervistat. Konkretisht, nga testimi me shkrim deri në

11 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, 15 qershor 2008, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>

12 Lista e ngushtë e kandidatëve të përzgjedhur për intervistë për anëtarë të Bordit të Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A. KEK, Zyra e Kryeministrit, 3 dhjetor 2024, i qasshëm në: <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/lista-e-ngushte-e-kandidateve-qe-jane-perzgjedhe-per-interviste-me-goje-per-anetare-te-bordit-korporata-energjetike-e-kosoves-sh-a-kek/>

13 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rregullorja (Grk) Nr. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (Grk) Nr.: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=83571>

14 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rregullorja (Grk) Nr. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (Grk) Nr. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=83571>

intervistat kishin kaluar 21 ditë.¹⁵ CorrWatch e ngriti këtë shqetësim me Ministrinë e Mbrojtjes duke rekomanduar anulimin e këtij procesi. Në të njëjtën kohë, CorrWatch ia ka adresuar këtë çështje edhe KPMSHCK-së, pasi që në të njëjtën kohë kanë trajtuar një ankesë për këtë procedurë, por jo për të njëjtën çështje. Megjithatë, CorrWatch nuk morri asnjë përgjigje dhe Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë tashmë është emëruar përmes kësaj procedure rekrutimi.

Poashtu në Agjencinë Pyjore të Kosovës, i njëjti rast është paraqitur dy herë. Herën e parë, komisioni i vlerësimit mori parasysh rekomandimin e CorrWatch¹⁶, ndërsa herën e dytë u shpërfillën¹⁷. Megjithatë, kjo procedurë rekrutimi është anuluar me vendim të KPMSHCK-së për shkak të ankesës së një kandidati, por për arsye krejtësisht të ndryshme. Kjo qasje tregon se afatet ligjore të parashikuara me ligjet në fuqi mbeten të prirura për parregullsi, duke qenë se ato nuk merren parasysh në disa raste as nga institucioni që drejton procesin e rekrutimit dhe as nga KPMSHCK, që luan rol mbikëqyrës.

Në anën tjetër, gjatë procesit të rekrutimit të drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale është tejkaluar afati për mbajtjen e testit me shkrim. CorrWatch ia ka adresuar këtë çështje institucionit dhe komisionit të vlerësimit, gjë që çoi në anulimin e procesit.¹⁸

2.4. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Burimet Njerëzore (SIMBNJ): fleksibiliteti i tij dhe si të shfrytëzohet më mirë

SIMBNJ është një platformë dixhitale e dedikuar për administrimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, duke përfshirë proceset e rekrutimit, në përputhje me kërkesat e LZP.

Duke pasur parasysh se SIMBNJ është krijuar për të lehtësuar dhe automatizuar procedurat e rekrutimit ndër të tjera, në raste të caktuara, CorrWatch ka vërejtur një hezitim nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMZP) për të zbatuar vendimet e institucioneve për kthimin e një procedure të caktuar në një fazë të mëparshme. Nga ana tjetër, ky nuk është rasti me vendimet e KPMSHCK-së pasi vendos të rivendosë një fazë, zbatimi i saj adresohet nga DMZP. Kjo qasje e diferencuar duhet të shmanget nga DMZP, pasi mungesa e fleksibilitetit dhe kompleksiteti i çështjeve nuk duhet të përdoret si arsye e qëndrueshme për të refuzuar zbatimin e vendimeve ligjore të marra nga institucionet përkatëse që trajtojnë një pozicion të caktuar rekrutimi. Në përgjithësi, DMZP duhet të përdorë një qasje proaktive dhe të parandalojë që raste të tilla të arrijnë në KPMSHCK, kurdo që është e mundur.

Një problem tjetër i konstatuar gjatë periudhës së monitorimit lidhet me eliminimin e kandidatëve për shkak të mosplotësimit të kriterëve të

¹⁵ Konkursi për Sekretar të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, SIMBNJ, i qasshëm në: <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00013607>

¹⁶ Konkursi për Drejtor Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, SIMBNJ, i qasshëm në: <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00014136>

¹⁷ Konkursi për Drejtor Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, SIMBNJ, i qasshëm në: <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00014828>

¹⁸ Konkursi për Drejtor Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Barnave, SIMBNJ, i qasshëm në: <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00014464>

shtetësisë, ku në shumë raste kandidatëve u mungon dokumenti që vërteton shtetësinë ose i njëjti ka skaduar. Në mënyrë paradoksale, këta kandidatë shpesh janë vetë punonjës të institucionit. Edhe pse SIMBNj është e lidhur me Regjistrin Civil, duke e bërë të pamundur krijimin e një llogarie pa qenë shtetas i Republikës së Kosovës – gjë që plotëson kushtin e përcaktuar në nenin 9 të LZP. Ndërsa SIMBNJ ofron një mbrojtje strukturore, efektiviteti i tij varet nga zbatimi i duhur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

2.5. Shkeljet Ligjore në Përbërjen e Komisioneve të Pranimi

Sipas LZP-së, komisionet e pranimi përbëjnë mekanizmin kryesor që siguron integritetin e një procesi rekrutimi të bazuar në merita. Këto komisione janë përgjegjëse për vlerësimin profesional të kandidatëve, që përbën fazën kryesore të një procedure rekrutimi, prandaj përbërja e tyre duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe me anëtarë të besueshëm dhe të padiskutueshëm.

LZP-ja, në Nenin 48, përcakton shprehimisht se “Komisioni Shtetëror i Pranimi për Pozitat e Kategorisë së Lartë Drejtuese ... ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje... 3.1. tre (3) nëpunës civilë ekzistues në pozita të kategorisë së lartë drejtuese”.¹⁹ Nga kjo dispozitë del qartë se për të qenë anëtar i Komisionit duhet të plotësohet kërkesa ligjore “të jesh nëpunës civil ekzistues në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese”. Ligji e ka përcaktuar me të drejtë këtë kriter, duke pasur parasysh nivelin dhe rëndësinë e kategorisë së lartë drejtuese dhe se ky kriter nuk plotësohet nëse anëtarët nuk janë nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese.

Megjithatë, CorrWatch ka vërejtur se në disa raste, ushtruesit e detyrës janë emëruar anëtarë të komisionit. Vendimet e tilla janë problematike për faktin se ushtruesit e detyrës shpesh janë nëpunës civilë të kategorive më të ulëta, pra nga kategoria e mesme dhe e ulët drejtuese, por edhe nga kategoria profesionale. Si rezultat, anëtarë të tillë nuk plotësojnë domosdoshmërisht kërkesat e nëpunësve civilë të kategorisë së nivelit të lartë menaxherial për të vlerësuar njohuritë, aftësitë dhe aftësitë e kandidatëve që aplikojnë për kategorinë e nivelit të lartë drejtues. Përveç mospërputhjes me LZP (të drejtën materiale), kjo praktikë përbën edhe paligjshmëri të procedurës sipas paragrafit 1.5 të nenit 52 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA).²⁰

Një dukuri tjetër në përbërjen e këtyre komisioneve, është emërimi si anëtarë i komisioneve, i Sekretarëve të Përgjithshëm apo pozicioneve të barasvlefshme që janë ende në periudhë prove. Ndërsa këto pozicione janë ende nën kushtin e konfirmimit të periudhës së provës, ato nuk duhet të shërbejnë si anëtarë të komisioneve të pranimi. Kjo u vërtetua edhe nga vendimet e KPMSHK-së²¹ që çuan në anulimin e një konkursi të tërë në disa nga rastet që kishin përbërje të tillë komisionesh.

¹⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-097 për Zyrarët Publikë, neni 48, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430>

²⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 52, paragrafi 1.5, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

²¹ Vendimi i KShMShK-së nr. A.nr.1679/2024 në rastin e konkursit për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së/MPIT dhe vendimi i KShMShK-së nr. A.nr.1703/2024 në rastin e konkursit për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore/MBPZHR. Vendimi i KShMShK-së nr. A.nr.1679/2024 në rastin e konkursit për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së/MPIT dhe vendimi i KShMShK-së nr. A.nr.1703/2024 në rastin e konkursit për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore/MBPZHR.

Një tjetër kërkesë ligjore për ngritjen e komisioneve të pranimit për postet e nivelit të lartë drejtues është miratimi i listës nga Qeveria me kandidatët potencialë për anëtarë të komisioneve dhe më pas të njëjtit përzgjidhen përmes sistemit kompjuterik në mënyrë algoritmike nga njësia përgjegjëse dhe emërohen nga Qeveria me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike. Një vit pas zbatimit të LZP, këto hapa procedurale nuk janë ndjekur nga Qeveria gjatë themelimit të këtyre komisioneve.

2.6. Sfidat në fazën e testimit me shkrim

Gjatë kësaj periudhe monitorimi, janë vërejtur parregullsi edhe gjatë procedurave të testimit me shkrim në disa raste, përfshirë ato që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e pyetjeve, shpërndarjen dhe bankën e pyetjeve. Rregullorja aktuale²² lejon që pyetjet të zgjidhen paraprakisht, pa rregulluar asnjë procedurë standarde për të shmangur problemet dhe abuzimet. Kjo praktikë ofron një rrezik potencial që pyetjet t'u shpërndahen në mënyrë të paligjshme kandidatëve. Një problem tjetër që lidhet me këtë është mungesa e një banke pyetjesh që mund të parandalojë gjithashtu shpërndarjen të mundshme të pyetjeve për kandidatët. Mungesa e një banke pyetjesh ka bërë që institucione të ndryshme të adoptojnë praktika të ndryshme në këtë drejtim, të mos kenë uniformitet dhe procedura standarde në përpilimin dhe përzgjedhjen e pyetjeve. Dy raste të hasura nga CorrWatch që ilustronjë këto probleme janë testi me shkrim për procesin e rekrutimit të Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) dhe për drejtorin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF). Për të parën, përgjigjet e dhëna nga komisioni për pyetjet e parashtruara përmbanin gabime, ndërsa për të dytën, pyetjet e parashtruara bazoheshin në ligjin e shfuqizuar për ndihmën juridike falas, siç ishte vërejtur edhe nga kandidatët.

Sa i përket esesë, si pjesë përbërëse e testit me shkrim, problemet qëndrojnë në faktin se nuk ka vlerësim të strukturuar të esëve, ka vonesa në vlerësimin e esesë pasi që anëtarët e komisionit bëjnë vlerësime në kohë dhe vende të ndryshme. Gjithashtu edhe temat e esesë nuk janë gjithmonë të përshtatura me pozitën dhe institucionin për të cilin kryhet procedura e rekrutimit.

2.7. Procesi i intervistimit: rënia e cilësisë

Gjatë kësaj periudhe monitorimi, është vërejtur një rënie në cilësinë e procesit të intervistimit. Ka pasur disa raste kur janë vërejtur problematika në krahasim me vitet e kaluara, dhe veçanërisht pasi ka përfunduar projekti i Ambasadës Britanike për pozitën e larta drejtuese.

Në shumë raste, anëtarët e komisioneve vlerësuese nuk mbajnë shënime të cilat janë esenciale për një vlerësim objektiv dhe të plotë. Gjithashtu nuk mbahet procesverbal i intervistave. Edhe pse nuk kërkohet me ligj, kjo do të krijonte një praktikë të mirë që do të kontribuonte në një proces më të mirë rekrutimi. Në të njëjtën kohë, tendenca për të diskutuar vlerësimet paraprakisht është e dukshme në disa raste. Në disa raste, anëtarët e komisionit priren të diskutojnë performancën e kandidatëve përpara se të sjellin vlerësime individuale, të cilat mund të ndikojnë qartë në objektivitetin e tyre. Për më tepër, vlerësimi i CV-së nuk është i detyrueshëm me ligj

²² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rregullorja (Grk) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, 30 tetor 2023, në lidhje në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=83571>

por parashikohet vetëm me akte nënligjore. Vlerësimi i CV-së ndjek një model standard të cilit i mungon struktura dhe nuk respekton standardet e përcaktuara të vlerësimit.

2.8. Refuzimi për lejimin e monitorimit të proceseve rekrutuese: situatë e paprecedentë

Në vitin e tretë, CorrWatch është përballur me një situatë të paprecedentë ku dy ministri kanë refuzuar kërkesat për monitorim të gjashtë (6) pozitave të larta drejtuese, duke shkelur kështu dispozitat e parashikuara me ligj, si dhe parimet e transparencës dhe meritokracisë. Një situatë e tillë është tregues se këto procese të mbyllura i nënshtrohen ndikimeve politike dhe personale, duke cenuar kështu besimin e qytetarëve në institucionet publike. Më e rëndësishmja, duhet theksuar se kuadri ligjor thekson se monitorimi i proceseve të rekrutimit nga shoqëria civile garantohet edhe nga legjislacioni në fuqi.²³

Dy ministri që refuzuan monitorimin e CorrWatch, janë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT). Më konkretisht, CorrWatch iu refuzua të monitorojë pozitat e mëposhtme menaxheriale të nivelit të lartë: Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve në MINT, Sekretar i Përgjithshëm në MFPT (në herën e tretë të hapjes së konkursit, pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

Lidhur me këtë çështje, CorrWatch ka reaguar publikisht për mungesën e transparencës së këtyre dy ministrive për këto procese kyçe të rekrutimit. Ndërkohë, më 18 shkurt 2024, CorrWatch përmes Qendrës për Raste Gjyqësore Strategjike ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me refuzimin për të monitoruar procesin e rekrutimit për Sekretarin e Përgjithshëm të kësaj ministrie.²⁴

2.9. Ndërrhyrjet e CorrWatch-it

Përveç rasteve që u shtjelluan më sipër si ndërhyrje në projekt, ka pasur edhe raste të tjera kur ndërhyrjet e CorrWatch kanë kontribuar drejtpërdrejt në ligjshmërinë e këtyre proceseve dhe rezultatin e tyre duke garantuar meritokraci dhe profesionalizëm.

Në procesin e rekrutimit për drejtor të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, pas ndërhyrjeve të CorrWatch, u përmirësuan kriteret për punën profesionale dhe përvojën menaxheriale. Bordi i Fondit kishte vendosur që të kërkonte 5 vjet përvojë pune profesionale dhe 2 vjet përvojë menaxheriale. CorrWatch e konsideroi këtë kriter të papranueshëm dhe kërkoi që përvoja të kërkohej në përputhje me LZP (8 vjet përvojë pune profesionale dhe 5 përvojë

²³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-097 për Zyrarët Publik, neni 48, paragrafi 7, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430>

²⁴ Qendra për Kontestet Strategjike, "Mohimi i së drejtës së shoqërisë civile për të monitoruar proceset e rekrutimit për postet e larta drejtuese" 18 shkurt 2025, në dispozicion në: <https://cslkosovo.org/2025/02/mohimi-i-te-drejtjes-se-shoqerise-civile-per-monitorim-te-procese-rekrutuese-ne-pozita-te-kategorise-se-larte-drejtuese/>

menaxheriale). Nisur nga fakti se kërkesat e përgjithshme formale – ku përfshihet edhe eksperiencia e punës – vendosen në bazë të nivelit të detyrave dhe përgjegjësive që ka një pozicion i caktuar, ndaj ulja dhe mospërbushja e tyre është një shkelle e rëndë që e bën të paligjshëm të gjithë procesin e konkurrimit. Në bazë të rekomandimeve të CorrWatch, institucioni në fjalë adresoi rekomandimet në konkursin e rihapur, duke rikthyer ligjshmërinë.²⁵

Nga ana tjetër, në konkursin e hapur në qershor 2024 për Sekretar të Përgjithshëm të MFPT-së, pas parregullsive në listën e ngushtë të kandidatëve, u morën parasysh rekomandimet e CorrWatch, duke rikthyer ligjshmërinë. Në këtë rast, MFPT kishte vendosur në listë një nga dy kandidatët që ishte pjesë e përzgjedhjes së ngushtë pavarësisht se nuk plotësonte kriteret e arsimimit të kërkuar. Me rekomandimin e CorrWatch, kandidati përkatës u largua dhe procedura u anulua për shkak të mungesës së dy kandidatëve që plotësonin kriteret.²⁶ Në një rast tjetër, në procesin e rekrutimit për drejtor të Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP), CorrWatch ka identifikuar se njëri prej kandidatëve, edhe pse kualifikohej për këtë pozitë, ishte përjashtuar nga lista e ngushtë. Pas rekomandimit të CorrWatch, MPB, si institucion kompetent për zhvillimin e procedurës, ka rishikuar listën në përputhje të plotë me sugjerimin e CorrWatch.

Në ndërmarrjet publike, konkretisht në konkursin për kryeshefin e KEKtë hapur në maj të vitit 2024, CorrWatch ka evidentuar disa probleme që kishin të bënin me kriteret e paqarta që mund të çonin në hutim tek kandidatët, por edhe me paligjshmërinë e të gjithë procesit. Në këtë konkurs, KEK kishte kërkuar nga kandidatët përvojë në ndërmarrje të të njëjtit kompleks, pa pasur standard për vlerësimin e kompleksitetit dhe madhësisë së një ndërmarrjeje. Në të njëjtën kohë, gjuha angleze kërkohej pa një dispozitë se si do të vlerësohej njohuria e gjuhës. Sa i përket arsimimit, ata nuk kishin kërkuar nostrifikimin e diplomës. Edhe pse ky konkurs është anuluar për arsye të panjohura, në konkursin e fundit të hapur në mars 2025, KEK ka adresuar të gjeturat dhe rekomandimet e CorrWatch, duke siguruar qartësi më të madhe dhe një proces në përputhje me kriteret ligjore.²⁷

2.10. Rekomandimet

Pas monitorimit sistematik dhe sfidave të shtjelluara në seksionet e mëparshme, CorrWatch ofron rekomandimet e mëposhtme për institucionet përkatëse:

- Zhvillimi i programeve të vazhdueshme të trajnimit për Njësitë e Burimeve Njerëzore (NBNj) dhe anëtarët e komisioneve ad-hoc të vlerësimit;
- Krijimi i një banke me pyetje, e cila mund të minimizojë problemet e hasura gjatë procesit të testit me shkrim;
- Planifikimi paraprak i proceseve të rekrutimit për të parandaluar fenomenin e ushtruesve të detyrës si dhe ndërprerjet e mundshme, duke siguruar një përdorim më të mirë të burimeve dhe efikasitet;
- Rritja dhe forcimi i dukshmërisë – publikimit së konkurseve përmes kanaleve të ndryshme për të arritur një numër më të madh të kandidatëve potencialë, duke

²⁵ Konkursi për Drejtor të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, SIMBNJ, i qasshëm në: <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00013449>

²⁶ Konkursi për Sekretar të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, SIMBNJ, i qasshëm në: <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00014278>

²⁷ Konkursi për Kryeshef Elzekutiv të KEK, i qasshëm në: <http://kek-energy.com/kek/thirrje-ftesa/>

marrë parasysh numrin e ulët të kandidatëve dhe dështimin e procedurave si pasojë e kësaj;

- Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të DMZP-së, veçanërisht duke marrë parasysh rolin e tyre të ri me rekrutimin e centralizuar që fillon nga marsi 2025;
- DMZP-ja, në bashkëpunim me institucionet që zbatojnë SIMBNJ-në, të kryejë një analizë të përgjithshme të sfidave të hasura. Bazuar në rezultatet e kësaj analize, sistemi duhet të përditësohet për të ofruar më shumë fleksibilitet dhe për të mbështetur më efektivisht zbatimin e procedurave të rekrutimit;
- Dokumentet që vërtetojnë shtetësinë të kërkohen në fazën përfundimtare të procedurës, së bashku me kushte/dokumente të tjera që verifikohen ose kërkohen në fazat e mëvonshme të procedurës;
- NP-të duhet të standardizojnë përmbajtjen e shpalljeve të konkurseve, formularëve të aplikimit dhe procesit të vlerësimit, duke promovuar procese të drejta dhe meritokratike të rekrutimit;
- KPMSHCK të publikojë vendimet për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie si dhe për të ruajtur standardet bazuar në ligj me qëllim të shmangies së standardeve të dyfishta gjatë vendimmarrjes.

3. Prokurimi Publik

Sikurse edhe në vitet e mëparshme, prokurimi publik vazhdon të mbetet i ndjeshëm ndaj korrupsionit, dhe njëherësh i karakterizuar me parregullsi që në fazën e hershme të planifikimit, e që është pikënisja e këtyre proceseve. Të dhënat nga periudha e monitorimit tregojnë se planifikimi i prokurimit publik mbetet i dobët në shumicën e niveleve institucionale. Nga ana tjetër, korniza legjislative mbetet ende për t'u përmirësuar, pasi projektligji i ri për prokurimin publik nuk u miratua gjatë kësaj periudhe dhe është ende pjesë e agjendës legjislative. Raporti i KE-së për Kosovën i vitit 2024 pranon progres të kufizuar në këtë fushë, me boshllëqe në zbatimin e rregulloreve dhe pajtueshmërinë që mbeten të rëndësishme. Për më tepër, raporti thekson se ligji i ri për prokurimin publik duhet të miratohet në harmoni me acquis-in e BE-së.²⁸

Duke marrë parasysh disa faktorë si numri i madh i kontratave, cenueshmëria ndaj korrupsionit, kosto e përfitimit, si dhe interesi publik, CorrWatch ka shënjestruar disa institucione siç janë: 1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, 2. Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, 3. Ministria e Punëve të Brendshme, 4. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe 5. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Gjatë kësaj periudhe, CorrWatch ka monitoruar dhe analizuar aktivitetet e mëposhtme të prokurimit publik:

1. MKRS – "Punët ndërtimore për realizimin e projektit të detajuar [kontraktori kryesor], arkitekturës dhe inxhinierisë, për konservimin dhe restaurimin e Muzeut Kombëtar të Kosovës dhe Teatrit Kombëtar të Kosovës, në Prishtinë"
2. MINT – Menaxhimi i Kontratës – „Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial në Opterushë"

²⁸ Raporti i KE-së për vendin 2024, Komisioni Evropian, 30 tetor 2024, Faqe 9, i qasshëm në: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf

3. Klinika Spitalore dhe Universitare e Kosovës – Furnizimi me barna nga LE për nevojat e Klinikës Spitalore dhe Universitare të Kosovës (00220-24-3862-1-1-1) – albumina
4. Klinika Spitalore dhe Universitare e Kosovës – Furnizimi me Barna nga LE për SHS-KUK (052) (00220-24-4095-1-1-1)
5. MMPHI – Rruga Prizren-Kufiri me Maqedoninë e Veriut
6. MMPHI – Lidhja e Vitisë me Autostradën
7. MMPHI – Zgjerimi i Rrugës Kombetare N9 – Segmenti Kijevë-Dollc, Loti 1,2,3,4.
8. MMPHI – Zgjerimi i Rrugës Kombetare N9, Prishtine-Pec, segmenti Dollc – Zahaq, Loti 1, 2, 3
9. Klinika Spitalore dhe Universitare e Kosovës – Furnizimi me aplikatorë, aksesorë dhe detektorë rrezatimi për aparatën e Brakiterapisë Flexitron HDR në Klinikën e Onkologjisë (00220-24-7111-1-1-1)
10. Klinika Spitalore dhe Universitare e Kosovës – Furnizimi me Barna nga LE për SHS-KUK-në – 082 (4 lote) (00220-24-6975-1-1-1)
11. MKRS – Hartimi i masterplanit për Kompleksin Memorial ‚Adem Jashari‘, në Prekaz, Komuna e Skenderajt, Republika e Kosovës.
12. MASHT – Ndërtimi i objektit të Fakultetit të Mjekësisë në Kampusin Universitar të Gjakovës, Faza I
13. MASHT – Blerje tekstesh për klasat 1-9 për vitin 2024/25
14. MKRS- "Punët ndërtimore për realizimin e projektit të detajuar [kontraktori kryesor], arkitekturës dhe inxhinierisë, për konservimin dhe restaurimin e Muzeut Kombëtar të Kosovës dhe Teatrit Kombëtar të Kosovës, në Prishtinë"
15. MKRS- Hartimi i masterplanit për Kompleksin Memorial ‚Adem Jashari‘, në Prekaz, Komuna e Skenderajt, Republika e Kosovës
16. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit: Ndërtimi i objektit të Fakultetit të Mjekësisë në Kampusin Universitar të Gjakovës, Faza I
17. MM – "Furnizimi me ushqime për nevojat e FSK-së"
18. MMPHI- "Ndërtimi i objekteve të banesave të përballeshme dhe sociale për komunat e Pejës, Gjilanit, Podujevës dhe Istogut"
19. Klinika Spitalore dhe Universitare e Kosovës- "Furnizimi me material shpenzues për elektrostimulim".

3.1. Mungesa e planifikimit të prokurimeve publike: konstantë e pandryshueshme

Planet e prokurimit të institucioneve publike mbeten ambicioze, kryesisht gjenerike dhe në një sërë rastesh jo reflektuese të nevojave dhe në shërbim të një shpenzimi publik të përgjegjshëm. Nga të dhënat e analizuara për vitin 2024, për të gjitha ministritë (përfshirë ZKM-në), asnjëra nga ministritë nuk e ka përfunduar plotësisht planin e tyre të prokurimit. Megjithatë, me performancën më të mirë janë rënditur: Ministria për Komunitete dhe Kthim (75% të zbatimit), Ministria e Mbrojtjes (68%), Zyra e Kryeministrit (64.7%), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (63.2%) si dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (60.50%). Ndërkaq, Ministria e Ekonomisë, e cila ka zbatuar vetëm 8.8% të planit të prokurimit publik dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me 12.2%, kanë përqindjen më të ulët të zbatimit.

| Institucioni | Aktivitetet e kontraktuara (përqindja) |
|--|--|
| Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 12,2 % |
| Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë | 33,3 % |
| Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit | 25,5 % |
| Ministria e Punëve të Brendshme | 40,6 % |
| Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës | 14,3 % |
| Ministria e Drejtësisë | 36,1 % |
| Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | 42,3 % |
| Ministria për Komunitete dhe Kthim | 75,0 % |
| Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | 63,2 % |
| Ministria e Ekonomisë | 8,8 % |
| Zyra e Kryeministrit | 64,7% |
| Ministria e Shëndetësisë | 53.2% |
| Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | 36.40% |
| Ministria e Mbrojtjes | 68.10% |
| Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | 60.50% |
| Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | 65,5 % |
| Ministria e Infrastrukturës | 19,6 % ²⁹ |

Në anën tjetër, të dhënat e analizuar nga CorrWatch në portalin e-Prokurimit zbulojnë se një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të prokurimit janë kontraktuar jashtë planit të prokurimit, duke treguar qartë mungesën e planifikimit të duhur të prokurimit publik. MKRS ka numrin më të madh të aktiviteteve të prokurimit të paplanifikuara, duke përmbledhur gjithsej 81 kontrata të paplanifikuara, e ndjekur nga MINT me 55 gjithsej. Ndërsa MASHTI dhe MMPHI kanë kontraktuar nga 54 aktivitete të prokurimit jashtë planeve të tyre të prokurimit.

²⁹ Përqindja e ndarë veçmas për mjedisin dhe planifikimin hapësinor dhe për infrastrukturën, duke qenë se kjo ministri pas bashkimit ende funksionon me plane të veçanta të prokurimit dhe secila ka divizionin e vet të prokurimit.

| Institucioni | Aktivitetet e kontraktuara (numri) |
|--|------------------------------------|
| Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | 81 |
| Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë | 55 |
| Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit | 54 |
| Ministria e Punëve të Brendshme | 40 |
| Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës | 30 |
| Ministria e Drejtësisë | 19 |
| Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | 54 |
| Ministria për Komunitete dhe Kthim | 13 |
| Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | 1 |
| Ministria e Ekonomisë | 16 |
| Zyra e Kryeministrit | 10 |
| Ministria e Shëndetësisë | 19 |
| Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | 6 |
| Ministria e Mbrojtjes | 11 |
| Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | 10 |
| Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | 13 |
| Ministria e Infrastrukturës | 41 ³⁰ |

3.2. Neglizhenca e qëllimshme e Ministrisë së Mbrojtjes

Në tetor 2024, u raportua se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) po përballej me mungesë ushqimi për personelin e saj. Në të njëjtin muaj, komandanti i FSK-së, Gjeneral, lejtant Bashkim Jashari i dërgoi një letër zyrtare Ministrisë së Mbrojtjes lidhur me këtë problem, duke kërkuar zgjidhje të shpejtë të situatës.³¹ Në të njëjtin muaj në Kuvendin e Kosovës është mbajtur seanca

³⁰ Përçindja e ndarë veçmas për mjedisin dhe planifikimin hapësinor dhe për infrastrukturën, duke qenë se kjo ministri pas bashkimit ende funksionon me plane të veçanta të prokurimit dhe secila ka divizionin e vet të prokurimit.

³¹ Klan Kosova, "Ushqimi në FSK: Letra ekskluzive e Jasharit, Maqedonci e anulon kontratën e sekretarit", 14 tetor 2024, e qasshme në: <https://klankosova.tv/ushqimi-ne-fsk-letra-ekskluzive-e-jasharit-maqedonci-e-anulon-kontraten-e-sekretarit/>

e jashtëzakonshme për problemin e furnizimit me ushqim.³² Megjithatë, çështja krijoi konfuzion dhe arsyet e kësaj situatë ishin të paqarta, dhe kishte raportime të ndryshme.

Për të kuptuar më qartë situatën dhe për të identifikuar shkaqet kryesore të problemit, CorrWatch ka bërë një analizë të plotë të këtij procesi, duke shqyrtuar të gjitha veprimet e ndërmarra nga Ministria e Mbrojtjes si institucion përgjegjës dhe autoritet kontraktues për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me FSK-në.

Në planin e prokurimit të Ministrisë së Mbrojtjes (MM) për vitin 2024, ishte paraparë aktiviteti i prokurimit "Shërbime ushqimore", i paraparë të fillojë më 23 shkurt 2024, me vlerë 13,480,000.00 euro. Që nga shkurti i vitit 2024, kur aktiviteti "Shërbimet ushqimore për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës" u anulua për herë të dytë, MM nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për iniciimin e procedurës së hapur. Më 3 prill 2024, MM ka lidhur një kontratë të negociuar që ka skaduar më 30 shtator 2024. Ministria e Mbrojtjes, më datë 19.09.2024, ka publikuar njoftimin për dhënien e kontratës së re në procedurë me negociim, duke përmendur emergjencat ekstreme, me vlerë të kontraktuar prej 2,149,000.00 euro.

Thënë kështu, MM mund të përdorë vetëm procedurat e negociuara në përputhje me nenin 35 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) i cili parasheh se "Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara... për arsye të urgjencës ekstreme të shkaktuara nga ngjarje objektivist të verifikueshme të cilat nuk mund të ishin parashikuar në mënyrë të arsyeshme nga autoriteti përkatës kontraktues".³³ Kjo dispozitë e ligjit përcakton saktësisht nëse emergjencat i atribuohen veprimeve ose mosveprimeve të pakujdesshme ose të qëllimshme. Sipas CorrWatch, urgjenca e shkaktuar i atribuohet mosveprimeve dhe neglizhencës së Ministrisë së Mbrojtjes. Bazuar në këtë, konsiderohet se MM-ja, duke zhvilluar një procedurë me negociim pa shpallje të njoftimit për kontratë, duke u thirrur në emergjenca ekstreme, ka shkelur nenin 35 të LPP-së. Gjithashtu, CorrWatch ka konstatuar se MM, gjatë negociimit të aktivitetit të fundit, ka kryer edhe një sërë shkeljesh të tjera. MM-ja ka ftuar vetëm tre operatorë ekonomikë për të negociuar, duke shkelur kështu nenin 7.1, i cili parashikon se "AK-ja nuk do të kryejë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton ose eliminon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë ose që diskriminon në dëm ose në avantazh të një ose më shumë operatorëve ekonomikë".³⁴ Edhe pse procesi ishte anuluar, fillimisht kontratat u ishin dhënë operatorëve ekonomikë që nuk i plotësonin kërkesat në dosjen e tenderit. Aktiviteti primar i operatorit ekonomik nuk i plotësonte kërkesat e përcaktuara nga Ministria.

Për të sqaruar më tej këtë çështje, CorrWatch ka adresuar publikisht këtë çështje, duke shpjeguar arsyet e mungesës së ushqimit për FSK-në dhe duke konstatuar se kjo situatë ka ardhur nga neglizhenca e Ministrisë së Mbrojtjes.³⁵

³² Telegrafi, "Kuvendi me seancë të jashtëzakonshme për FSK-së", Tetor 2024, e qasshme në: <https://telegrafi.com/kuvendi-seance-te-jashtezakonshme-per-fsk-se/>

³³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 35, paragrafi 2, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

³⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 7, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

³⁵ Koha.net, "CorrWatch: Neglizhenca e Ministrisë së Mbrojtjes shkaktoi problemin me ushqim në FSK", 17 October

3.3. Keqmenaxhimi i vazhdueshëm i MASHTI-t me furnizimin me tekste shkollore për nxënësit

Në vitin 2023 dhe 2024, MASHTI vendosi të furnizojë tekste shkollore përmes subvencioneve. Në vitin 2023, ky vendim është arsyetuar me dështimin e Ministrisë për të negociuar me kompanitë e përfshira në procesin e prokurimit, ndërsa në vitin 2024 nuk është dhënë asnjë shpjegim i hollësishëm. Në vitin 2024, për të dytin vit radhazi, MASHTI ka bërë shkelje ligjore edhe pse ka një vit të plotë për të siguruar që procesi i furnizimit me tekste të jetë në përputhje me ligjin. CorrWatch e ka trajtuar këtë çështje publikisht duke përshkruar shkeljet ligjore dhe pasojat e mundshme që mund të sjellë ky proces.³⁶

Më konkretisht, MASHTI ka vijuar shkeljen e kuadrit ligjor aktual duke ua bartur përgjegjësinë për blerjen e teksteve nga ministria te prindërit. Ligji aktual për arsimin parauniversitar thotë se “..tekstet jepen pa pagesë”, si dhe paragrafi 1 parashikon se “...ministra miraton tekstet dhe mjetet dhe materialet e tjera mësimore sipas rregullave të prokurimit”.³⁷ Në këtë rast, MASHTI nuk ka përmbushur detyrimin që i takon duke ua bartur përgjegjësinë prindërve në vend që ta adresojë atë përmes prokurimit siç parashikon ligji.

MASHTI në planin e prokurimit për vitin 2024 kishte planifikuar aktivitetin e prokurimit “Blerja e librave nga klasa 1-9 për vitin 2024/25” në vlerë prej 9,486,885.00 euro, por nuk është realizuar. Aktiviteti ishte planifikuar të niste më 28 qershor 2024, por ministria nuk ndërmoi asnjë masë për fillimin e procedurave të prokurimit, duke e neglizhuar plotësisht. Në vend që të përmbushte detyrimin ligjor dhe planin e tij të prokurimit, MASHTI ndoqi të njëjtën praktikë të subvencionimit si një vit më parë, ndonëse është dëshmuar se është më e shtrenjtë sa i përket buxhetit. Më tej, MASHTI ka deklaruar se shumica e përcaktuar për t’u ndarë përfshin përlogaritjen për materialet mësimore, e cila është në kundërshtim me ligjin që parashikon që vetëm tekstet shkollore ofrohen falas.

Në vitin 2023, kjo metodë e subvencionimit ka kushtuar mbi 11 milionë euro më shumë se vlera e planifikuar për procedurën me negociim me kompanitë, gjë që ka sjellë edhe anulimin e procedurës. Ndërkohë në vitin 2024 kjo shumë është tejkaluar dhe mbi 20 milionë euro janë shpenzuar³⁸

Këto shkelje të institucionit tregojnë për mospërmbushje të detyrimeve dhe planifikim joadekuat në mënyrë ad-hoc që nuk garanton qëndrueshmëri. Për më tepër, shpenzimet e bëra, të cilat tejkalojnë të gjitha periudhat e mëparshme, tregojnë për një menaxhim të dobët të parasë publike.

2024, e qasshme në: <https://www.koha.net/en/arberi/corrwatch-neglizhenca-e-ministrise-se-mbrojtjes-shkaktoi-problemin-me-ushqim-ne-fsk>

36 CorrWatch, “REAGIM PUBLIK – Mbi Krijimin e Praktikave të Paligjshme dhe Mospërmbushjen e Detyrimeve Ligjore të Ministrisë së Arsimit për Furnizimin e Teksteve Mësimore”, 14 gusht 2024, e qasshme në: <https://corrwatch.org/2024/08/14/reagim-publik-15/>

37 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 26, paragrafët 1 dhe 4, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

38 Të dhënat për shumën janë marrë përmes kërkesës për qasje në dokumente publike të datës 30 shtator 2024. Përgjigja nga MASHTI është marrë më 29 janar 2025.

3.4. Rekomandimet

Në fushën e prokurimit publik, CorrWatch propozon rekomandimet e mëposhtme:

Institucionet përkatëse duhet të përmirësojnë planifikimin e tyre duke bërë një analizë të detajuar të shumës që do të shpenzohet, duke reflektuar nevojat dhe në të njëjtën kohë duke bërë një afat kohor të saktë për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të prokurimit.;

Institucionet duhet të zbatojnë një sistem monitorimi për të ndjekur zbatimin e planeve të prokurimit;

Institucionet duhet të zhvillojnë mekanizma për të siguruar menaxhim efikas të kontratave;

Zhvillimi i specifikimeve teknike të sakta dhe gjithëpërfshirëse për të gjitha aktivitetet e prokurimit;

Angazhohuni me palët e interesuara për të mbledhur komente dhe për të përmirësuar vazhdimisht procesin e prokurimit.

4. Shpërndarja e Granteve dhe Subvencioneve

Në Kosovë, çështjet e transparencës dhe llogaridhënies kanë çuar në mosbesimin e qytetarëve për mënyrën se si ndahen grantet dhe subvencionet nga institucionet publike. Kjo mungesë transparence ka krijuar mundësi për korrupsion dhe keqpërdorim të fondeve. Përveç kësaj, pa sistemet e duhura të monitorimit dhe vlerësimit, është e vështirë të vlerësohet ndikimi i tyre dhe nëse ato i shërbejnë qëllimit të tyre parësor. Kjo do të thotë se burimet e vlefshme mund të mos arrijnë tek njerëzit që kanë më shumë nevojë për to dhe është e rëndësishme që këto probleme të trajtohen për të mirën e të gjithëve në vend. Për të adresuar këto çështje, metodologjia CorrWatch përdor një qasje gjithëpërfshirëse e cila fokusohet në disa fusha kyçe, duke përfshirë:

- Planifikimi strategjik dhe ndarja e mbështetjes financiare.
- Mbikëqyrja e komisioneve vlerësuese dhe mekanizmave për adresimin e ankesave.
- Zhvillimi i kriterëve të qarta për procesin e aplikimit.
- Sigurimi i transparencës dhe qartësisë në publikimin e thirrjeve për aplikime, procedurat e vlerësimit dhe shpalljen e rezultateve.
- Sigurimi i integritetit të kontratave me përfituesit.

Që nga fillimi i projektit dhe gjatë kësaj periudhe raportuese, CorrWatch është fokusuar në monitorimin e dy institucioneve kyçe që përfshijnë MBPZHR dhe MKRS. Arsyeja për këtë përzgjedhje bazohet në rolet e tyre kryesore në menaxhimin e fondeve të konsiderueshme në sektorë jetikë si bujqësia

dhe kultura. Vlen të theksohet se në MKRS, CorrWatch ka monitoruar vetëm një thirrje, pasi për më shumë se 1 vit ky institucion nuk i është përgjigjur kërkesave të projektit për monitorim, rrjedhimisht duke mos e lejuar atë.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Programi i Zhvillimit Rural 2023 - Thirrja për Grante

Thirrja për Programin e Zhvillimit Rural 2023³⁹ u monitorua në mënyrë retroaktive, pasi monitorimi i drejtpërdrejtë nuk lejohej pavarësisht kërkesave të shumta për monitorim aktiv gjatë gjithë procesit.

Një çështje kryesore ishte vonesa e konsiderueshme në nisjen e thirrjeve për grante, e cila u hap gati një vit më vonë se sa pritej. Gjithashtu, ndryshe nga vitet e kaluara, është vërejtur një zbrapsje shqetësuese nga praktikrat e mëparshme, pasi nuk është bërë thirrje publike për të lejuar organizatat e shoqërisë civile të marrin pjesë në monitorimin aktiv të thirrjes për hapjen e granteve. Ndërkohë, pas përfundimit të thirrjes publike, CorrWatch avokoi për publikimin e listës së plotë të përfituesve të granteve për vitin 2023. Megjithatë, kjo listë u bë e disponueshme vetëm në fund të vitit 2024, duke ngritur shqetësime për mungesën e transparencës dhe llogaridhënies që mund të çojë në dyshime për keqpërdorim.

Gjetjet e CorrWatch tregojnë se nga 446 përfitues, 48 nuk figurojnë në faqen zyrtare të Agjencisë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, gjë që ngre dyshime për verifikimin e duhur të aplikantëve. Për më tepër, 14 përfitues kanë regjistruar aktivitete që nuk kanë të bëjnë me bujqësinë dhe 123 përfitues kanë regjistruar bizneset e tyre në të njëjtin vit që kanë aplikuar për grante. Gjithashtu u identifikua se 4 përfitues janë identifikuar si biznese joaktive, që do të thotë se nuk kanë kryer aktivitete ekonomike duke ngritur dyshime nëse ata e kanë zbatuar projektin.

Programi i Zhvillimit Rural 2024 - Thirrja për Grante

Ashtu si me thirrjet e mëparshme, Programi i Zhvillimit Rural të vitit 2024⁴⁰ u hap gjithashtu me një vonesë të konsiderueshme. Thirrja për grante 2024 u shpall vonë në dhjetor, 2024. Për këtë çështje ka reaguar publikisht CorrWatch, duke kërkuar hapjen në kohë të thirrjes dhe duke kërkuar që Ministria të rishikojë kriteret e përshtatshmërisë.⁴¹ CorrWatch ka konsideruar se kriteret e përshtatshmërisë duhet të sigurojnë që përfituesit e granteve të kenë kapacitetin dhe qëndrueshmërinë e nevojshme për të kryer investimet e tyre. Për më tepër, mbështetja e bizneseve pa histori të qartë funksionimi ose të atyre në rrezik mbylljeje pas marrjes së granteve është një qasje e papranueshme dhe në kundërshtim me qëllimet dhe objektivat.

Thirrja pati disa ndryshime pozitive në kuadrin legjislativ. Është e

³⁹ Programi i Zhvillimit Rural 2023, 30 Tetor 2023, i qasshëm në: https://azhb-rks.net/repository/docs/2023_10_30_084249_Programi_per_Zhvillim_Rural_2023.pdf

⁴⁰ Programi i Zhvillimit Rural 2024, 12 dhjetor 2024, i qasshëm në: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/16.12.2024_Shqip_Final_Final_Update_PZHR_2024.pdf

⁴¹ Koha.net, "CorrWatch kërkon nga Ministria e Bujqësisë që t'i hapë me kohë thirrjet për grante e t'i rishikojë kriteret", 26 Dhjetor 2024, i qasshëm në: <https://www.koha.net/arberi/corrwatch-kerkon-nga-ministria-e-bujqesise-qe-ti-hape-me-kohe-thirrjet-per-grante-e-ti-rishikojë-kriteret>

rëndësishme të theksohet se thirrja është aktive, ndaj CorrWatch ka analizuar vetëm përmbajtjen e saj, duke identifikuar aspektet pozitive dhe ato që mungojnë.

Një përmirësim kyç është kërkesa për regjistrimin dhe etiketimin e kafshëve, gjë që e bën më të lehtë monitorimin në terren dhe ndihmon në parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme të granteve dhe subvencioneve. Ky hap gjithashtu përmirëson transparencën duke siguruar që fondet shkojnë për marrësit e kualifikuar dhe duke reduktuar rrezikun e mashtrimit gjatë inspektimeve. CorrWatch e ka vlerësuar publikisht këtë akt. Gjithashtu, ndryshe nga thirrja për grante në vitin 2023, seksionet e shtuara pasqyrojnë përmirësimet kryesore që u inkorporuan pas avokimit dhe rekomandimeve të CorrWatch drejtpërdrejt në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë. Këto ndryshime tregojnë masa më të forta të mbështetjes financiare për bizneset bujqësore, duke siguruar qasje më të gjerë në mundësi financimi. Një shtesë e rëndësishme është detyrimi për aplikantët që të angazhojnë studentë ose të sapodiplomuar në projekte bujqësore, në përputhje me shtytjen tonë për përfshirje të zgjeruar të të rinjve dhe ngritje të kapaciteteve në këtë sektor. Për më tepër, këto seksione paraqesin qartësi më të madhe në alokimet e financimit, duke specifikuar përqindjet e ndihmës financiare publike dhe duke rafinuar kriteret e pranueshmërisë për të krijuar një proces financimi më gjithëpërfshirës dhe transparent.

Nga ana tjetër, seksionet e hequra nga thirrja e grantit fokusohen kryesisht në kriteret e rëndësishme të pranueshmërisë për aplikantët, si pronësia e tokës, kontratat e vlefshme dhe dokumentacioni i nevojshëm. Këto seksione përshkruan kushtet e kërkuara për investime në pajisje bujqësore si traktorë, vegla bujqësore dhe serra, duke specifikuar kërkesat minimale të tokës dhe dëshminë e aktivitetit bujqësor. Këto kriteret ishin thelbësore për të siguruar që vetëm aplikantët legjitim të merrnin mbështetje financiare. Duke i hequr ato, procesit tani i mungojnë garancitë e nevojshme për të parandaluar keqpërdorimin e fondeve, duke e bërë të vështirë sigurimin që grantet të shpërndahen në mënyrë të drejtë tek marrësit e duhur. Pa udhëzime dhe kontrole të qarta, ka një shans më të lartë për favorizim, mashtrim ose dhënie fondesh për ata që nuk i përmbushin qëllimet e programit. Kjo mungesë qartësie redukton ndjeshëm transparencën e të gjithë procesit.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Ftesë Publike për Funkcionalizimin e Monumenteve të Trashëgimisë Kulturore

Në gusht 2024, MKRS publikoi thirrjen me titull "Ftesë publike për funksionalizimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore."⁴² Qëllimi i kësaj thirrje ishte që përmes fondeve publike të angazhohen Organizatat Joqeveritare (OJQ) që të kujdesen për tri aspekte: së pari, Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Kalasë së Prizrenit; së dyti, Zbatimi i Planit të Menaxhimit për Parkun Arkeologjik Ulpiana – Iustiniana Secunda; dhe së treti, Funkcionalizimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore, konkretisht: a. Burgu Ideal - Prishtinë; b. Hidrocentrali - Muzeu i Elektroekonomisë - Prizren; c. Kulla e Ministrit - Pejë; d. Galeria e Arteve - Agim Çavdarbasha - Çagllavicë, Prishtinë. Shuma e ndarë për këtë thirrje ishte 1.1 milionë euro për të gjitha kategoritë.

Thirrja u nda në dy faza, si në të gjitha thirrjet: në fazën e vlerësimit administrativ dhe në fazën e vlerësimit përmbajtësor. Monitorimi i CorrWatch identifikoi se gjatë vlerësimit administrativ, komisioni nuk ishte plotësisht i formuar dhe gjatë procesit, ai kishte arritur një konsensus për të skualifikuar një nga organizatat aplikuese nga kalimi në fazën e vlerësimit thelbësor, duke përmendur arsyen se organizata nuk kishte paraqitur ankesën e saj në kohë.

CorrWatch identifikoi se vendimi për të mos përzgjedhur një organizatë ishte i pabazuar pas analizimit të rastit. Gjithashtu, konsorciumi kërkoi që vlerësimet të mos kryhen pa praninë e të gjithë anëtarëve të komisionit, siç kërkohet nga Rregullorja 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve.⁴³ Janë mbajtur takime edhe me MKRS-në dhe janë marrë parasysh rekomandimet e CorrWatch. Si rezultat, MKRS themeloi një komision ankesash plotësisht në përputhje, duke iu përmbajtur kërkesave ligjore dhe duke u siguruar që ankesat nga të gjitha OJQ-të, përfshirë një të tjetër, të trajtohen. Megjithatë, nga 15 aplikime, vetëm nëntë OJQ mund të kalonin në fazën e vlerësimit thelbësor. Dhe pas vlerësimit thelbësor, vetëm dy OJQ u mbështetën financiarisht për të realizuar një pjesë të qëllimit të thirrjes.

⁴² Ftesë Publike për Funkcionalizimin e Monumenteve të Trashëgimisë Kulturore, 7 gusht 2024, e qasshme në: https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Ftese_Publike_Funksionalizimi_i_Monumenteve.pdf

⁴³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr. - 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14831>

Rekomandime:

Për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

- Të rishikohen kriteret e pranueshmërisë për subvencionet dhe grantet ashtu që të jenë më gjithëpërfshirëse, duke siguruar që të përfitojnë një gamë më e gjerë fermerësh dhe të inkurajojnë zhvillimin e tregut lokal;
- Të vendosen afate të qarta kohore për përgatitjen dhe ekzekutimin e programeve të granteve, në përputhje me sezonet bujqësore për të lejuar miratimin dhe zbatimin në kohë;
- Të dixhitalizohen procedurat e aplikimit për të thjeshtuar proceset, për të zvogëluar vonesat dhe për të rritur transparencën, duke e bërë më të lehtë për fermerët të aplikojnë për grante;
- Të zbatohen inspektime të rregullta pas zbatimit dhe vlerësime të tregut për të siguruar llogaridhënien, vlerësimin e efektivitetit dhe përmirësimin e rezultateve të skemave të granteve.
- Të zbatohen sanksione për aktivitete mashtruese për të mbrojtur integritetin e procesit të shpërndarjes së granteve dhe për të ruajtur transparencën, duke siguruar që fondet të shkojnë për marrësit legjitim.
- Të rritet koordinimi midis autoriteteve qendrore dhe lokale për të parandaluar përfituesit e dyfishtë, për të siguruar shpërndarje të barabartë dhe për të shmanhur përqendrimin e burimeve.
- Të zgjerohen sistemet e regjistrimit dhe etiketimit të bagëtive për të përmirësuar monitorimin në terren, për të parandaluar keqpërdorimin e granteve dhe për të siguruar që subvencionet arrijnë tek përfituesit e kualifikuar.
- Të promovohet ndërgjegjësimi dhe transparenca e publikut duke i bërë të disponueshme publikisht të dhënat e përfituesve të granteve dhe duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile në monitorimin e rregullt, duke nxitur llogaridhënien dhe besimin në proces.

Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

- Dixhitalizimi i të gjitha proceseve për thirrjet e hapura;
- Krijimi i Strategjive Kombëtare për Sportin dhe Kulturën, në mënyrë që çdo fond publik i shpenzuar përmes thirrjeve të hapura të ketë një objektiv të qartë;
- Krijimi i bazave të të dhënave për përfituesit sipas gjinisë;
- Miratimi i modelit estonez për financimin e Artit dhe Kulturës ku të gjitha taksat e vendosura për cigaret dhe alkoolin shërbejnë si kanal financimi për këta sektorë;
- Ndërlidhja mes artit dhe diplomacisë si në modelin e Holandës;
- Forcimi i mekanizmave të monitorimit të projektit për të siguruar zbatimin efektiv

5. Lëshimi i Licencave, Lejeve dhe Tarifave

CorrWatch i është mohuar pjesëmarrja aktive në monitorimin e procesit të lëshimit të lejeve pranë Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Në lidhje me MMPHI, kjo pengesë u shtri edhe në procesin e shqyrtimit të kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), pavarësisht nenit 5 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ⁴⁴ që lejon në mënyrë eksplicite përfaqësuesit e shoqërisë civile të marrin pjesë si vëzhgues.

Mospërputhje në lejet e lëshuara

Edhe pse debatet publike janë trefishuar në krahasim me vitet e mëparshme— kryesisht për shkak të përpjekjeve dhe avokimit të CorrWatch—të dhënat tregojnë se shumë dokumente ende nuk po bëhen publike. Kjo mungesë e vazhdueshme e transparencës, e shoqëruar me rezistencën ndaj mbikëqyrjes efektive të shoqërisë civile, krijon kushte që mund të nxisin keqpërdorimin e fondeve publike dhe korrupsionin e mundshëm. Pa reforma vendimtare për të përmirësuar zbulimin dhe monitorimin, llogaridhënia do të mbetet e dobët, duke minuar edhe më shumë besimin e publikut.

Tabela 1. Tabela 1. Numri i kërkesave për leje, vendimeve, VNM-ve dhe debateve të publikuara për periudhën 2021-2023

| Viti | Kërkesat për leje nga regjistri | Nr. i VNM-ve të publikuara në faqen e internetit të MMPHI | Numri i debateve të publikuara në faqen e internetit të MMPHI-së |
|----------|---------------------------------|---|--|
| 2024 | 199 | 111 | 70 |
| 2023 | 120 | 27 | 30 |
| 2022 | 146 | 0 | 5 |
| 2021 | 148 | 0 | 0 |
| Cjithsej | 613 | 138 | 105 |

⁴⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, neni 5, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68708>

Deshtimi për Hapjen e Konkursit për Licencimin e Personave Juridik për Përgatitjen e Raporteve të VNM-së

Edhe pse lista e personave të licencuar për hartimin e VNM është bërë publike, ajo ka mbetur e pandryshuar që nga publikimi fillestar. Krahas kësaj, MMPHI vazhdimisht nuk shpall thirrje për licencimin e personave juridikë për përgatitjen e raporteve të VNM-së. Sipas Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, neni 12, paragrafi 2, kërkohet nga Ministria të përcaktojë procedurat dhe kriteret për licencimin e personave fizik dhe juridik përmes një akti nënligjor.⁴⁵

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ i MMPHI-së Nr. 10/2017 për Licencimin e Përpiluesve të Raportit të VNM-së⁴⁶ specifikon se Ministria duhet të hapë një thirrje për licencim çdo vit. Megjithatë, kanë kaluar afro katër vite pa patur thirrje të re. Kjo vonesë, e kombinuar me mungesën e reagimit të MMPHI-së, ngre shqetësime për integritetin e procesit të licencimit, veçanërisht duke pasur parasysh se një raport i VNM-së është një dokument vendimtar për vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve mjedisore të projekteve të zhvillimit.

CorrWatch e konsideron këtë vonesë si një çështje serioze, duke reflektuar qartë mungesën e transparencës dhe llogaridhënies. Mungesa e zgjatur e thirrjes për licencë ka krijuar në mënyrë efektive një monopol, duke përfituar një grup të përzgjedhur individësh që mund të shfrytëzojnë situatën për përfitime personale.

Të dhëna nga monitorimi i debateve publike nga CorrWatch për dhënien e lejeve:

Nga marsi 2024 deri në shkurt 2025 (04.02), janë monitoruar drejtpërdrejt gjithsej 70 debate publike;

Në tre nga këto debate, vegëza digjitale e ofruar nuk ishte e vlefshme;

Një debat nuk u mbajt;

- Në 66 debate publike ishte i pranishëm vetëm një përfaqësues nga MMPHI;
- Vetëm 5 nga këto debate patën pjesëmarrës shtesë, përfshirë qytetarët;
- 33 nga këto debate janë shpallur nga komunat përkatëse;
- 32 debate nuk janë shpallur nga komuna;
- Në një rast, faqja e internetit e komunës nuk ishte e qasshme;
- Kohëzgjatja mesatare e debateve publike varionte nga 10 deri në 17 minuta.

Nga ana tjetër, nga 111 raportet e publikuara të VNM-së, 20% janë përgatitur nga vetëm një person nga 31 profesionistë të licencuar. Mbështetja në një individ të vetëm për përgatitjen e raporteve të VNM-së ngre shqetësime serioze në lidhje me drejtësinë dhe besueshmërinë e vlerësimeve. Kjo përgjegjësi e përqendruar rrit rrezikun e vlerësimeve të njëanshme, gabimeve dhe madje edhe manipulimeve të qëllimshme, pasi nuk ka perspektiva të

⁴⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 12, Paragrafi 2, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68708>

⁴⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ MESPI Nr. 10/2017 për Licencimin e Përpiluesve të Raportit të VNM-së, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15180>

ndryshme apo mbikëqyrje të pavarur. Pa një proces rishikimi bashkëpunues, gjasat për boshllëqe, anashkalime ose keqinterpretime rriten, duke hapur derën për aktivitete mashtruese. Kjo mungesë llogaridhënieje mund të dëmtojë saktësinë e raporteve dhe të nxisë korrupsionin, duke dëmtuar përfundimisht besimin e publikut në të gjithë procesin.

Një ndryshim pozitiv i vërejtur ishte se në korrik 2024, përmes avokimit të vazhdueshëm të CorrWatch, MMPHI vendosi që, përveç ministrisë, një kopje e raportit të VNM-së t'i dorëzohet edhe komunës përkatëse. Sigurimi disponueshmërisë së raportit të VNM-së për qytetarët në zonat ku është planifikuar projekti kontribuon në rritjen e përfshirjes, llogaridhënies nga palët e përfshira dhe transparencës institucionale.

Tarifat nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRE):

Në vitin 2024, CorrWatch monitoroi proceset e mëposhtme:

- Raport konsultativ për të ardhurat maksimale të lejueshme për vitin 2024;
- Raporti Konsultativ mbi të Ardhurat Maksimale të Lejuara (AML) të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSh) për vitin 2024;
- Aplikimi për të Ardhurat Maksimale të Lejuara për Ofruesin e Shërbimit Universal (OSHF) – 2024;
- Aplikimi për të Ardhurat Maksimale të Lejuara për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSh) – 2024;

Gjatë kësaj periudhe është bërë progres i dukshëm në rritjen e transparencës në procesin e përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike në Kosovë. Të gjitha rregulloret dhe dokumentet mbështetëse në lidhje me tarifat janë bërë të qasshme për publikun. Kjo ka krijuar një hapësirë më të madhe për informimin e konsumatorëve. Gjithashtu, gjatë viteve të fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të konsultimeve publike me palët e interesuara përpara ndryshimeve në tarifat e energjisë. Ky proces ka mundësuar një diskutim më të hapur dhe gjithëpërfshirës për të gjitha grupet e përfshira. Dhe së fundi, të dhënat për kostot operative, të ardhurat dhe investimet e kompanive energjetike kanë qenë të qarta dhe të detajuara për publikun. Këto përmirësime kanë ndikuar në forcimin e besimit të konsumatorëve dhe palëve të interesuara në këtë proces të rëndësishëm.

Rekomandimet

- Institucionet si MMPHI dhe KPMM duhet të lejojnë monitorimin aktiv nga organizatat e shoqërisë civile dhe të rrisin transparencën përmes publikimit proaktiv të të dhënave dhe dokumenteve;
- Të thelohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve kyçe për marrjen e lejeve si ZRE, MMPHI, ME, dhe zyrtarëve komunal që të kontribuojnë në një proces më transparent dhe më të përgjegjshëm në planifikimin dhe zbatimin e politikave;
- Të krijohet një "One-Stop-Shop" për të lehtësuar procesin e dhënies së lejeve dhe licencimit për të mundësuar një burim të vetëm për informacion, udhëzime dhe shërbime gjithëpërfshirëse në këtë mënyrë për të reduktuar barrën administrative për bizneset dhe institucionet;
- Të përmirësohet qasja dhe përfshirja në debate publike në lidhje me lejet duke siguruar që të gjitha debatet të shpallen siç duhet, të qasshme si dhe të përfshijnë një gamë të gjerë pjesëmarrësish duke i promovuar ato në kanale të ndryshme;

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRÉ) duhet të miratojë një proces gjithëpërfshirës të vlerësimit për propozimet për investime nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, për të integruar të dhëna të detajuara dhe për të kërkuar vlerësime me njohuri nga inspektimet në terren dhe auditimet e brendshme;
- Të vendosen udhëzime të qarta që detajojnë kornizat kohore dhe burimet e të dhënave – veçanërisht nga Bursa Evropiane e Energjisë – të përdorura në parashikimin e kostove të importit të energjisë;
- Të sigurohet që të gjitha komentet dhe vëzhgimet nga konsultimet publike të përfshihen plotësisht në raportet përfundimtare të të Hyrave Maksimale të Lejuara (HML);
- Përtej sqarimeve teknike, ZRRÉ duhet të angazhojë në mënyrë proaktive një grup më të gjerë të palëve të interesuara dhe qytetarëve në procesin e konsultimit. Zhvillimi i një dokumenti konsultimi të dedikuar dhe miqësor për përdoruesit do të lehtësonte kontributet dhe komentet publike, duke rritur kështu transparencën dhe llogaridhënien e përgjithshme.

6. Performanca e Ndërmarrjeve Publike

CorrWatch ka vazhduar përpjekjet monitoruese në drejtim të menaxhimit dhe transparencës së NP-ve të synuara, duke vëzhguar një numër të caktuar zhvillimesh pozitive, si në aspektin e tyre financiar ashtu edhe atë operacional. CorrWatch ka theksuar vazhdimisht nevojën për të adresuar barrën e tepërt të fuqisë punëtore brenda NP-ve dhe ka mbrojtur sistematizimin dhe ristrukturimin e vendit të punës. Si rezultat, disa NP kanë ndërmarrë hapa konkretë në këtë drejtim. Për shembull, përveç Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) "Prishtina" e cila ka ndërmarrë masa konkrete në këtë drejtim, ndërmarrja hekurudhore Infrakos dhe Kompania e Ujitjes "Ibër-Lepenci" kanë zbatuar edhe disa masa për përmirësimin e efikasitetit përmes procesit të sistemimit dhe riorganizimit.

Megjithatë, një sfidë e vazhdueshme është ndryshimi i shpeshtë i ushtruesve të detyrës së drejtorëve, kryeshefave ekzekutivë dhe anëtarëve të bordeve brenda NP-ve. Për shembull, KEK-u dhe Trepça SH.A. aktualisht janë duke operuar me një ushtrues të detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordi i Trepçës ka pësuar dy ndryshime në përbërje gjatë vitit të kaluar.

Ndryshe nga statusi i transparencës i vitit të kaluar – ku monitorimi i CorrWatch zbuloi çështje të rëndësishme, duke përfshirë qasjen e kufizuar të publikut dhe shoqërisë civile në NP dhe publikimin jo konsistent të raporteve dhe planeve të biznesit nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike – këtë vit ka pasur përmirësime të dukshme. Dokumentet strategjike si raportet vjetore, planet e biznesit dhe raportet e kënaqësisë së konsumatorit tani po publikohen në përputhje me kërkesat ligjore për shumicën e NP-ve.

Aktivitetet monitoruese në NP-të e synuara

Numri i mbledhjeve të monitoruara të Bordit të Drejtorëve

Numri i mbledhjeve të monitoruara të Bordit të Drejtorëve

| Institucioni | T1 (Prill -Qershor) 2024 | T2 (Korrik -Shtator) 2024 | T3 (Tetor -Dhjetor) 2024) | T4 (Janar -Mars) 2025 |
|------------------------------------|--------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|-----------------------------|
| KRU Prishtina | 3 | 1 | 3 | 0 |
| KEK | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Termokos | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Infrakos | 0 | 1 | 3 | 1 |
| Iber Lepenci | 2 | 1 | 2 | 0 |
| Fondi i Sigurimeve Shëndetësore | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Gjithsej | 6 | 4 | 9 | 1 |

Gjatë këtyre takimeve, CorrWatch mori informacione kritike nga NP-të, të cilat shërbyen si bazë për rekomandime në lidhje me funksionimin e tyre dhe performancën e përgjithshme. Avokimi i CorrWatch për sistematizimin e vendit të punës – në veçanti, reduktimi i punësimit të tepërt që sforcon kapacitetin financiar dhe operacional të NP-ve – ka çuar në disa suksese. Për shembull, në vitin 2024, në Infrakos, 12 punonjës pranuan vullnetarisht një paketë largimi, duke marrë pagën e një viti në këmbim të largimit nga pozicioni i tyre. Me përmirësimin e praktikave të menaxhimit, kompania rriti të ardhurat nga qiraja me 29% krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, investimet strategjike mbeten një sfidë e rëndësishme për pothuajse të gjitha NP-të, pasi ato shpesh mbështeten në huatë direkte nga qeveria ose organizatat ndërkombëtare. Një paketë e ngjashme për dalje vullnetare është zbatuar edhe në Ibër-Lepenci, ku i njëjti numër i të punësuarve janë larguar nga pozitat e tyre. Për më tepër, proceset komplekse të investimeve kanë vonuar projektin e zgjerimit të kanalit të ujit të kompanisë, i cili varet nga financimi si nga qeveria ashtu edhe nga Banka Botërore.

Siç vërehet në tabelën e mësipërme, CorrWatch u përball me vështirësi në monitorimin e dy NP-ve – përkatësisht KEU-ut dhe Termokos-it. Në rastin e KEK-ut, ndryshimet e shpeshta në Bordin e Drejtorëve e prishën komunikimin dhe gatishmërinë për bashkëpunim. Ndërkohë, për Termokos, CorrWatch e ndërpreu në mënyrë të njëanshme memorandumimin për shkak të mungesës së komunikimit dhe dështimeve të përsëritura për të ftuar CorrWatch për të monitoruar mbledhjet e Bordit, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme.

Lidhur me sfidat e tjera të përhapura me të cilat ballafaqohen të gjitha KRU-të në Kosovë—veçanërisht regjistrimi i klientit për qëllime të faturimit—KRU Prishtina ka ndërmarrë hapa konkretë për të përmirësuar efikasitetin e faturimit. Kompania ka filluar të hartojë konsumatorët duke përdorur Google My Maps, duke dixhitalizuar të gjitha hartat dhe fotot e

skanuara për të përmirësuar aksesin e të dhënave dhe për të ofruar një pasqyrë gjeohapësimore në kohë reale. Ky sistem përfshin informacion mbi konsumatorët ekzistues, zonat e shërbimit, burimet e ujit, agjentët e faturimit, zonat e monitorimit, statusin e rrjetit, të dhënat e faturimit, matësat e ujit dhe treguesit e leximit të njehsorëve. Për më tepër, aplikacioni ndihmon në identifikimin e konsumatorëve të rinj dhe ndërtesave të reja.

Publikimi i Vendimeve të Bordit dhe Masat për Transparencë

Një shembull pozitiv në lidhje me qasje në vendimet e bordit është Posta e Kosovës, e cila i ka ofruar CorrWatch qasje në të gjitha të dhënat e mbledhjeve të bordit nga viti 2021. Disponueshmëria e procesverbaleve dhe vendimeve të bordit është thelbësore për vlerësimin e efektivitetit dhe cilësisë së qeverisjes brenda NP-ve. Këto dokumente ofrojnë njohuri mbi diskutimet e bordit, proceset e vendimmarrjes dhe kontributet individuale të anëtarëve të bordit. Në Telekom, përpjekjet për të tërhequr vendimet e bordit kanë rezultuar në marrjen e rreth 45 vendimeve të bordit nga dy vitet e fundit. Angazhimet me zyrtarët përgjegjës janë duke vazhduar për të përmirësuar procedurat e qasjes në dokumente. Megjithatë, legjislacioni ekzistues që kufizon zbulimin e sekreteve të biznesit e ka komplikuar procesin. Për të adresuar këtë, CorrWatch ka këshilluar Telekomin të krijojë një sistem klasifikimi që bën dallimin midis vendimeve të bordit të klasifikuara dhe jo të klasifikuara. Kjo masë pritet të rrisë transparencën, efikasitetin dhe reagimin ndaj kërkesave për dokumente publike.

Njëkohësisht, CorrWatch ka avokuar për më shumë transparencë në vënien në dispozicion të këtyre dokumenteve në publik. Fillimisht, Njësia për monitorimin e NP-ve ka bërë publike vendimet e bordeve të NP-ve për: 1) Trepçë-në, 2) KEK-un, 3) KMKD-në, 4) KRU Gjakova, 5) KRU Mitrovica, 6) KRU Prishtina, 7) KRU Radoniqi-Dukagjini, 8) Iber Lepenc-in, 9) Trainkos-in, dhe 10) Infrakos-in. Publikimi i vendimeve të bordit është vonuar për dy NP (Postën e Kosovës dhe Telekomin), për shkak të çështjeve të brendshme, siç janë politikat e privatësisë, mirëpo procesi është në vazhdim e sipër. Në anën tjetër, NP-të në vijim nuk kanë dhënë qasje në vendimet e bordit: 1) KRU Hidrodrini; 2) KRU Bifurkacioni; 3) KRU Hidromorava; 4) KRU Drini i bardhë dhe 5) KRU Hidroregjioni jugor.

Menaxhimi dhe Mbledhja e Borxhit

Përmes një analize të vendimeve të shumta të bordit, CorrWatch ka identifikuar sfida të rëndësishme me të cilat përballen NP-të në rikuperimin e borxheve të papaguara nga klientët. Për shembull, diskutimet me KRU Prishtina identifikuan faktin se afërsisht 40% e klientëve të tyre janë të paidentifikueshëm për shkak të të dhënave të vjetruara të konsumatorëve. Kjo mungesë e të dhënave të sakta paraqet një pengesë të madhe për mbledhjen efektive të borxhit. Si përgjigje, CorrWatch ka iniciuar koordinimin ndërmjet KRU Prishtina dhe Agjencisë së Shoqërisë Informative (ASHI), e cila menaxhon platformën e-Kosova, për të lehtësuar përditësimin e bazës së të dhënave.

CorrWatch lehtësoi takimet dypalëshe midis Zyrtarët Kryesorë Financiarë (ZKF-ve) dhe përfaqësuesve nga ASHl, me qëllim që të eksploroheh zgjidhjet dixhitale për mbledhjen e borxheve edhe për kompani të tjera. U krye një anketë, e ndjekur nga një forum avokues ku zyrtarët e ASHl-it prezantuan potencialin e integritit të shërbimeve të NP-ve në platformën e-Kosova. Si rezultat i këtyre diskutimeve, KRMM Ambienti rinovoi me sukses kërkesën për t'iu bashkuar e-Kosova, ndërsa KRU Bifurkacioni filloi diskutimet për integrimin e shërbimeve të saj në platformë.

Në anën tjetër, sa i përket mbledhjes së borxheve, ekziston një situatë konfuzive sa i përket pagesave të mbeturinave në Komunën e Prishtinës. Në shkurt të vitit 2025, kryetari i Prishtinës shpalli gjendjen e jashtëzakonshme për menaxhimin e mbeturinave.⁴⁷ Për më tepër, ndryshimi i Rregullores Nr. 01-030/01-227581/23 ka shkaktuar konfuzion të madh, pasi parashikonte se vetëm një kompani, konkretisht Kompania Rajonale e Pastrimit të Mbeturinave (KRPM Pastrimi), do të kishte të drejtën ekskluzive për të faturuar dhe mbledhur pagesat për këtë sektor duke filluar nga 1 janari 2025.

Më 5 shkurt 2025, Komuna e Prishtinës njoftoi pezullimin e rregullores së re,⁴⁸ duke theksuar se do të vazhdojë faturimi dhe arkëtimi i pagesave për menaxhimin e mbetjeve. Por, KRPM Pastrimi e kundërshtoi këtë vendim, duke e konsideruar atë juridikisht të pabazuar. Si rezultat, mbetet e paqartë se cili institucion do të jetë përgjegjës për faturimin dhe mbledhjen e pagesave.

CorrWatch ka reaguar publikisht për këtë situatë dhe i ka bërë thirrje Komunës së Prishtinës dhe KRM Pastrimi që urgjentisht të sqarojnë këtë situatë dhe të shmangin konfuzionet e mëtejshme për qytetarët.⁴⁹

Përfshirja gjinore në NP

Ligji aktual për NP-të rregullon vetëm aspektet gjinore – pra përfaqësimin e barabartë të të dyja gjinive në Bordin e Drejtorëve. Megjithatë, ai nuk rregullon asnjë sektor tjetër brenda NP-ve. Ligji ka treguar se ka arritur një shkallë të konsiderueshme të barazisë në Bordin e Drejtorëve në pothuajse të gjitha NP-të – në raste edhe përfaqësim më të madh nga gratë. Megjithatë, në sektorë të tjerë si administratë dhe menaxhim ka disa përmirësime, por hendeku është ende mjaft i lartë.

CorrWatch publikoi një pyetësor të detajuar gjinor që synon NP-të dhe Njësinë e NP-ve, duke rezultuar në një raport statistikor që zbulon se vetëm 11% e të punësuarve në NP janë gra.⁵⁰

⁴⁷ Radio Evropa e Lirë, "Prishtina shpall gjendje të jashtëzakonshme nga mbeturinat", 3 shkurt 2025, e qasshme në: <https://www.evropaelire.org/a/prishtina-gjendje-jashtezakonshme-nga-mbeturinat-/33301278.html>

⁴⁸ Koha.net, "Prishtina pezullon rregulloren për mbeturinat: Pagesat për "Pastrimin" sërish përmes Komunës", 5 shkurt 2025, e qasshme në: <https://www.koha.net/arberi/pagesat-per-pastrimin-serish-permes-komunes>

⁴⁹ CorrWatch, "REAGIMI PUBLIK – Për të zgjidhur problemin e grumbullimit të mbeturinave dhe mënyrën e faturimit dhe arkëtitimit të pagesave për klientët e Komunës së Prishtinës" 20 shkurt 2025, e qasshme në: <https://corrwatch.org/2025/02/20/reagim-publik-20/>

⁵⁰ CorrWatch, "Punësimi dhe përfaqësimi i grave në ndërmarrjet publike qendrore në Kosovë", Dhjetor 2024, e qasshme në: <https://corrwatch.org/2024/12/24/punesimi-dhe-perfaqesimi-i-grave-ne-ndermarrjet-publike-qendrore-ne-kosove/>

Rekomandimet

- Hartimi dhe miratimi i politikave dhe rregulloreve të brendshme për trajtimin e kërkesave publike për dokumente të cilat mund të kategorizohen si "të klasifikuara";
- Të adresohet fenomeni i ushtruesit të detyrës së kryeshefëve ekzekutiv dhe anëtarëve të bordit duke iniciuar në kohën e duhur proceset e rekrutimit;
- Të krijohet një format unik raportimi për të gjitha NP-të në mënyrë që dallimet në performancë të mund të analizohen më lehtë;
- Të sigurohet që të gjitha vendimet e bordit, planet e biznesit dhe raportet financiare të publikohen rregullisht dhe të jenë të qasshme për publikun;
- Të prezantohen dhe zbatohen politika që promovojnë barazinë gjinore duke siguruar përfaqësim të barabartë midis të gjitha niveleve, përfshirë bordin, menaxhmentin dhe administratën;
- Të inicohet sistematizimi i vendeve të punës në NP-të që nuk kanë marrë përsipër këtë reformë;

Raporti Vjetor i Corrwatch 2024 - 2025

03/2025



British Embassy
Pristina



Group for Legal
and Political
Studies



INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

